



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

“Psikologji Klinike”

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

PhD. Eglantina DERVISHI 

Dr. Anisa SUBASHI 

Prill / 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Mp në "Psikologji Klinike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Mp në "Psikologji Klinike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 89, datë 10.02.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 192, datë 25.01.2011 Vendim Senati Nr. 6 datë 28.02.2018 Miratuar me shkrese MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 379, datë 06.09.2013
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 19, datë 02.03.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	5 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	6 studentë
19	Komente / të tjera:	-



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Albanian University, (AU) ish shkolla e lartë universitare jopublike "Ufo dental" është licensuar me VKM Nr. 197, datë 10.04.2004¹. Ka ndryshuar statusin dhe është riorganizuar sipas VKM Nr.597, datë 28.5.2009 për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat "UFO University"² dhe gjithashtu mbështetur në VKM Nr. 603, datë 24.8.2011, për ndryshimin e emrit të universitetit privat nga "UFO University" në "Albanian University"³. Riorganizimi institucional është mbështetur në urdhrin e MAS Nr.52, datë 05.02.2016⁴. Albanian University është akredituar për herë të parë nga bordi i akreditimit me vendim Nr. 90, datë 20.10.2017 "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat "Albanian University"⁵. Riakreditimi i dytë bazohet në Vendimin e BA-së, Nr. 01, date 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat "Albanian University"⁶, me kohëzgjatjen prej 3 (tre) vite.

Albanian University përbëhet nga 3 Fakultete:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;
3. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

Njësia bazë që e ofron Masterin Profesional në "Psikologji Klinike" është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme që është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Ky program studimi është licensuar me VKM Nr.89, datë 10.02.2010 si Master i Nivelit të Dytë (MND)⁷. Programi është riorganizuar nga MNP në MP me Vendim Senati Nr. Prot. 192, datë 25.01.2011⁸. Vlerësimi në kuadër të akreditimit të parë me Vendim Nr. 355, datë 13.07.2012⁹ jepet pozitiv, por me disa rekomandime (Master Profesional, MP) dhe në Urdhërin e MASH Nr. 327, datë 07.08.2012¹⁰. Me vendim senatin nr. 6 datë 28.02.2018, është riorganizuar programi ne 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik. Ky riorganizim është miratuar me

¹Vendimi dt.10.04.2004 Për dhënien e lejes për hapjen e SHLUJUFO Dental. Dokumenti nr 9.

²Vendimi Për ndryshimin e emrit dhe hapjen e programeve të reja të studimit pranë SHLUP UFO Dental. Dokumenti nr 10.

³Vendimi Për ndryshimin e emrit të Universitetit Privat "Ufo University", dokumenti nr 11.

⁴Urdhër për riorganizimin institucional të IAL (MAS – Albanian University). Dokumentin nr 12.

⁵Vendimi për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë Universiteti Privat "Albanian University". Dokumenti nr 13.

⁶Vendimi për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të lartë, Universiteti Privat "Albanian University". Dokumenti nr 14.

⁷Vendimi Nr 89, datë 2010-02-10. Për hapjen e programeve të reja të studimeve në SHLP UFO University. Dokumenti nr 1.

⁸Vendim senati Nr., 2011-01-25. Për riorganizimin e programeve, Universiteti Privat "Albanian University". Dokumenti nr 4.

⁹Vendim Nr. 355, datë 2012-08-07. Universiteti "Albanian University", Për akreditimin e Programeve të Studimit që përfundojnë me "Master i Shkencave në Menaxhim Bankar"; "Master i Shkencave në Adminstrim Binzesi"; "Master Profesional në Psikologji Klinike" dhe "Master i Shkencave në Psikologji Klinike". Dokumenti nr 3.

¹⁰Urdhër Nr. 327, datë 2012-08-07. Për Akreditimin e programeve të studimit Msc dhe MP të "Albanian University". Dokumenti nr 2.

shkresën e MASR Nr. 6313/2 prot, date 18.07.2018¹¹. Programi është akredituar me VBA Nr. 19, date 02.03.2019¹², me kohëzgjatje 1 vit akademik. Afati vlefshëmërisë së akreditimit është 30.09.2020, i realizuar me 60 kredite (ECTS), në formën e studimit me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Psikologji Klinike”.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Duke u bazuar në Vendimin Nr. 19, datë 2019-03-02.¹³ Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University” vlersohet pozitivisht me kohëzgjatje 1 vjeçare me rekomandimet e mëposhtme:

- 1. Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, të specializuar në fushën e psikologjisë klinike, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga stafi akademik efektiv në masën 70%¹⁴**

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë është në masën 90 %. Por kemi një sërë të dhënash kontraktore lidhur me angazhimin e stafit akademik të angazhuar në procesin mësimor në këtë program studimi. Dokumentacioni përmban CV-të e 6 prej pedagogëve të cilët janë angazhuar në mësimdhënie në MP “Psikologji Klinike”, A. Ç¹⁵ staf akademik me kohë të pjesëshme, B.L.¹⁶, D. T¹⁷, I.H¹⁸, P. L¹⁹ si dhe S. I²⁰ janë staf akademik me kohë të plotë. Për E. I. nuk është vënë në dispozicion një CV dhe as nuk figuron tek syllabuset si lektore për ndonjërin prej lëndëve mësimore për MP “Psikologji Klinike” edhe pse është pjesë e listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”²¹. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar

¹¹Shkresa Nr., datë 2018-07-08. Kthim përgjigje nga MARS për riorganizimin e MP, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti

¹²Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

¹³Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

¹⁴Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

¹⁵CV A. Ç. DOKUMENTI NR 62.

¹⁶CV B. L. DOKUMENTI NR 63.

¹⁷CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

¹⁸CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹⁹CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

²⁰CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

²¹Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një mospërputhje midis Cv-ve të dërguar për stafin akademik i cili është angazhuar në këtë program studimi, listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”²² dhe lektorit që e realizon ngarkesën në auditor. Konkretisht tre lektoret I.H.²³; E. I. dhe S. I.²⁴ nuk rezultojnë të përfshira në syllabuset e lëndëve që realizohen në MP. “Psikologji Klinike”. Gjithashtu ndeshemi me një tjerët paqartësi, ku duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se lektori D.T.²⁵ është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore²⁶; ²⁷; ²⁸ dhe gjithashtu P. L.²⁹ është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore³⁰; ³¹; ³²; ³³. Kujtojmë se duke iu referuar planit mësimor të programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike”³⁴ numri i lëndëve përfshirë dhe temën e diplomës është në total 10 lëndë mësimore, ku **8 prej tyre mbulohen nga 2 lektore**, 4 lëndë mësimore për secilin. Bazuar në këto të dhëna shihet me dyshim jo vetëm përmbushja e këtij rekomandimi por edhe rreziku i cënimit të cilësisë në mësimdhënie, ku një profesionist mbulon njëherësh një sër lëndësh. Kjo situatë bëhet më e paqartë nëse profili profesional i titullarit/lektorit nuk i përket profilit klinik³⁵. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se ky **rekomandim përmbushet pjesërisht**.

2. Institucioni të lidhë e verë në zbatim marrëveshje të posaçme bashkëpunimi me Institucione të specializuara në fushën e psikologjisë klinike, në kuadër të realizimit të praktikës profesionale të studentëve³⁶

Në funksion të praktikës profesionale janë nënshkruar një sër marrëveshje me intitucione si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”³⁷ etj, pa afat. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione të specializuara në fushën e psikologjisë klinike u japin mundësi studentëve të zhvillojnë praktikën profesionale pranë qendrave që kanë shërbim psikologjik dhe psikologë klinikë në organikën e tyre. Në këtë

²²Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

²³CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

²⁴CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

²⁵CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

²⁶Intervista klinike. Dokumenti nr 22.

²⁷Psikoterapitë në praktikën klinike. Dokumenti nr 28.

²⁸Sistemet aktuale diagnostike. Dokumenti nr 29.

²⁹CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

³⁰Konceptimi dhe analiza e rasteve klinike. Dokumenti nr 23.

³¹Praktikë Profesionale. Dokumenti nr 24.

³²Psikologji Pozitive. Dokumenti nr 26.

³³Vlersimi dhe testimi psikologjik. Dokumenti nr 30.

³⁴Plani mësimor. Dokumenti nr 15.

³⁵CV P. L. Dokumenti NR 66

³⁶Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodic të programit të studimit të ciklit të dyrë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

³⁷Raporti vjetor 2019-2020.

mënyrë krijohen kushtet që studentët të përfitojnë nga përvoja dhe profesionalizmi i profesionistëve të terrenit. Vlen të theksohet se qendrat e sipërpërmendura janë në përputhje me profilin e masterit profesional në “Psikologji Klinike” duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij program studimi. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet plotësisht.**

3. Institucioni të realizojë një studim tregu me qëllim mundësimin e një vlerësimi objektiv të nevojave të tregut të punës për psikologë klinik dhe lehtësimin e përpilimit të objektivave për të ardhmen³⁸

Institucion ka realizuar një studim të tregut të punës³⁹ me qëllim që të identifikojë nevojat e tregut për profilin e profesionistit “psikolog klinik”. Metodologjia e përdorur bazohet kryesisht në shqyrtim dokumentacioni dhe në një pjesë të tyre nuk kemi mundësi të verifikojmë të dhënat mbi të cilat nxirren përfundimet pasi mungojnë referencat. Por kryesisht ky studim është realist në parashikimin e mundësive në rritje për një psikolog klinik për tu orientuar në tregun e punës. Kjo referuar edhe hapësirave që ky profil ka në një sërë kontekstesh profesionale që mbulohen nga psikologë. Gjithashtu plotësimi i kriterëve për liçensim nga Urdhri i Psikologut është me ndikim pozitiv në vijimësinë e këtij profili profesional. Nuk del qartë mënyra sesi janë monitoruar alumnit ndër vite dhe sa janë duke punuar në profilin e tyre profesional. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet plotësisht.**

4. Institucioni të verë në dispozicion të studentëve të këtij program studimi, në bibliotekë, literaturën e nevojshme të parashikuar në syllabuset e lëndëve të këtij program studimi si dhe ta pasurojë atë me tituj mbështetës për avancimin e mëtejshëm profesional të studentëve⁴⁰

Duke iu referuar dokumentacionit ⁴¹ të vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se nga Departamenti është bërë një kërkesë për literaturë në gjuhën shqipe të cilat sugjerohet t'i shtohen fondit të bibliotekës së fundmi në funksion të përmbushjes së nevojave të këtij programi profesional. Por duhet theksuar se kjo literaturë jo në të gjitha rastet është e 5 viteve të fundit dhe se një pjesë e saj është literaturë që përdoret si tekst bazë për ciklin e parë të studimit. Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Questia, Eric dhe U-library- COBISS për qëllime të

³⁸Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

³⁹Evidenca R 3. Dokumentin nr 8.

⁴⁰Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

⁴¹Evidenca R4. Nr.169. Mbi pasurimin e bibliotekës me libra të rinj.



shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve⁴². Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet kryesisht.**

- 5. Institucioni të shohë mundësinë e lidhjes dhe vënies në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra dhe institucione në fushën e Psikologjisë klinike dhe fusha të tjera të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me të, në kuadër të përfshirjes së studentëve në aktivitete ku të prezantohen teknikat terapeutike në trajtimin e çrregullimeve të ndryshme psikologjike të organizuar nga pedagogë të ftuar nga jashtë institucionit⁴³.**

Duke iu referuar dokumentacionit Institucioni ka realizuar një sër aktivitetesth ekstrakurrikulare që ofrohen për studentët e këtij institucioni nga ana e njërive kryesore dhe bazë. Gjithashtu njëria bazë përgjegjëse për programin profesional në “Psikologji Klinike” bazuar në dokumentacionin e dërguar, ka realizuar leksione të hapura me lektorë të ftuar, aktivitete bamirësie⁴⁴ etj. Vlen të theksohet si tepër pozitive cikli i leksioneve të hapura me “Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë”⁴⁵ për studentët lidhur me njohjen e mjeteve që lehtësojnë qasjen ndaj informacionit, bibliotekës dixhitale etj. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet plotësisht.**

- 6. Institucioni të shohë mundësinë e ofrimit të programeve specifike për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor⁴⁶**

Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos⁴⁷. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesth⁴⁸ si tryeza e rrubullakët mbi organizimin e një ore mësimi me lektoren e ftuar A. Sh si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom”, kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale. Bazuar në të dhënat e shqyrtuara grupi i vlersimit të jashtëm gjykon se **ky rekomandim përmbushet plotësisht.**

⁴²RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat e vulosura. Dokumenti nr 3.

⁴³Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodic të programit të studimit të ciklit të dyrë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.


⁴⁴Lista e aktiviteteve 2019-2020. Dokumenti nr 38.

⁴⁵Raporti vjetor 2019-2020. Dokumenti nr 34.

⁴⁶Vendimi Nr. 19, datë 2019-03-02. Për akreditimin periodic të programit të studimit të ciklit të dyrë, MP në “Psikologji Klinike”, Universiteti Privat “Albanian University”. Dokumenti nr 10.

⁴⁷Trajnimi i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

⁴⁸Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Qëllimi i këtij vlerësimi për programin e studimit 1 vjeçar master profesional në “Psikologji Klinike” është vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të cilat janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017. “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Vlerësimi i programit të studimit është një proces vlerësimi nga ekspertë të jashtëm i përcaktuar me urdhër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Për përcaktimin e Ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti Privat “Albanian University”. Grupi i vlerësimit të jashtëm i përbërë nga PhD. Eglantina Dervishi (drejtuese e grupit), Dr. Anisa Subashi (anëtare), Msc.Majlinda Demireli (koordinatore teknike) nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Raporti përfundimtar do të shërbejë jo vetëm për akreditimin e programit bazuar në shkallën e përmbushjes së standardeve, por gjithashtu informon Universitetin Privat “Albanian University”, MASR, publikun e gjerë dhe studentët sesi programi i studimit përmbush standartet. Përmes këtij raporti njësia kryesore dhe bazë kanë mundësi të identifikojnë prioritetet në drejtim të rritjes dhe zhvillimit, duke e vënë theksin tek përmirësimi i cilësisë në drejtim të një procesi që zhvillon kompetencat profesionale për studentët. Standartet Shqiptare Shtetërore të Cilësisë janë të grupuara në gjashtë fusha kryesore vlerësimi bazuar tek Ofrimi, Organizimi dhe Drejtimi i Programit të Studimit Master Profesional; Struktura dhe Përmbajtja e Programit të Studimit Master Profesional; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet për Realizimin e Programit të Studimit dhe Mbështetja e Studentëve; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të Studimit Master Profesional. Vlerësimi i secilës fushe bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve me 4 nivele: a- nuk përmbushen; përmbushen pjesërisht; përmbushen kryesisht; përmbushen plotësisht. Raporti në tërësinë e tij identifikon pikat e forta të programit të studimit bazuar në karakteristikat e praktikës së mirë, pikat e dobëta të cilat prekin cdo fushë, mundësitë që ka në dispozicion programi në drejtim të avancimit drejt cilësisë dhe pengesat, të cilat mund të vështirësojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbi bazën e këtyre indikatorëve grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet profesionale që do të shërbejnë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike”.

Universiteti Privat “Albanian University” është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 29.03.2021, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 11/5 Prot, datë 29.03.2021. Universiteti Privat “Albanian University” përcjell në ASCAL më datë 01 Prill, me anë të shkresës me Nr. 165/1 Prot, datë 01.04.2021 “Përgjigje për draft raportin e vlerësimit të jashtëm”.



Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- Lidhur me komentin që bëhet për **realizimin e rekomandimit të akreditimit të mëparshëm** “Institucioni të rekrutojë staf të ri akademik efektiv, me grada dhe tituj, të specializuar në fushën e psikologjisë klinike, me qëllim mbulimin e ngarkesës mësimore nga stafi akademik efektiv në masën 70%”, GVJ ka marrë në konsideratë se:

Bazuar në dokumentacionin e dërguar pranë ASCAL është realizuar edhe vlersimi i rekomandimeve të dhëna nga akreditimi i mëparshëm i këtij programi studimi. Supozohet se institucioni dërgon të dhëna transparente dhe uniforme gjë e cila ndihmon grupin e vlersimit të jashtëm në punën e tij për hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm. Bazuar edhe në dokumentat e vëna në dispozicion së fundmi sërish grupi i vlersimit të jashtëm i qëndron komenteve të bëra më parë prej tij lidhur me këtë rekomandim. Komentet tona bazohen tek syllabuset e dërguara për vitin akademik 2020-2021, dhe gjithashtu lista emërore të pedagogëve të angazhuar në këtë master për vitin akademik 2020-2021. Si syllabuset e lëndëve dhe stafi i angazhuar në një program studimi rifreskohen dhe miratohen para fillimit të vitit akademik dhe nuk ndyshohen në mes të tij. Gjetjet tona bazohen pikërisht në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion i cili e ritheksojnë ka një mospërputhje në të dhëna.

- *Lidhur me komentin që bëhet për pedagogun E.I. GVJ ka marrë në konsideratë se:*

Dokumentacioni është një element i rëndësishëm i cili pasqyron edhe normalitetin që egziston brenda strukturës lidhur me burimet njerëzore, të cilat janë në mbarëvajtjen e këtij programi studimi, të cilat duhet të garantojnë një lloj qëndrueshmërie. Dokumentacioni me të dhëna të ndryshme mbetet përgjegjësi e institucionit jo e grupit të vlersimit të jashtëm.

- *Lidhur me komentin që bëhet për pedagogun S.I. GVJ ka marrë në konsideratë se:*

Komenti ynë si grup vlerësimi lidhet me mospërfshirjen e saj në listen e parë emërore të pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi dhe jo me faktin se nuk është pjesë e syllabusit të lëndës. Gjë që sipas gjykimit tonë duket më në përputhje me profilin profesional të këtij masteri sesa titullari dhe lektori i kësaj lënde. Programi master profesional në “Psikologji Klinike” nuk ka si qëllim të formësoj profile të ndërmjetme profesionale, dhe e theksojmë se profilet e ndërmjetme kanë logjikë kur bëhen brenda profileve të përafërta (ref. EUROPSY).

- *Lidhur me komentin që bëhet për pedagogun I.H. GVJ ka marrë në konsideratë se:*

Pedagogia në fjalë gjatë takimit me GVJ u shpreh se kishte rreth 10 vite që e jepte lëndën e përmendur dhe kontradita qëndron tek fakti që nuk është pasqyruar në syllabuset e lëndëve “të rifreskuara” 2020-2021” si lektore. Dokumentacioni zyrtar i institucionit duhet pasqyruar dhe ruajtur me kujdes, nuk mund të shkruhet e rishkruhet sipas “oreksit të momentit”. Serioziteti i institucionit shihet tek fakti që të dhënat nuk shkruhen e rishkruhen pas konstatimeve dhe problematikave të evidentuara nga grupi i vlersimit të jashtëm.

- *Lidhur me komentin që bëhet për pedagogun P.L. GVJ ka marrë në konsideratë se:*


Grupi i vlersimit të jashtëm vlerëson faktin që njësia bazë synon ofrimin e personelit me grada dhe tituj. Por është gjithashtu një detyrim ligjor dhe moral për të gjithë institucionin që të

tregojmë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm në respektimin e kritereve për të ofruar një shërbim që studentët e meritojnë dhe për të cilin paguajnë. Kjo nuk do të thotë se çdo pedagog me tituj akademik mund të japë mësim në çdo disiplinë mësimore, pa parë më parë nëse profili i tij profesional dhe kualifikimet ia lejojnë këtë hapësirë, (pasi në këtë mënyrë rrezikojmë që “studentëve të mjekësisë ti cojmë tu japë mësim edhe veterineri”). Kjo sugjerohet të shihet me vëmendje aq më tepër kur bëhet fjalë për një profesion të rregulluar nga shteti, i cili mund të ushtrohet vetëm pasi të jesh licensuar më parë. Çdo lloj ndërthurje tjetër në profile të përafërta çënon të drejtën e studentëve për arsim cilësorë, sidomos kur flasim për lëndë karakterizuese me natyrë tepër profesionale, për të cilat gjykojmë se minimalisht të përzgjidhet një person i cili ka mundësi të marrë licencën për ushtrimin e profesionit të psikologut, që të jetë në gjendje t’u mësojë studentëve diçka në lidhje me psikologjinë klinike. Konstatimi ynë vjen si rezultat i profilin profesional të këtij masteri i cili është tepër specifik dhe e drejton figurën e psikologut në kontekstin klinik, me tëpër duke bashkëpunuar me profesionistë të fushës së psikiatrisë sesa ato të filozofisë e pedagogjisë. Shumë lëndë të këtij masteri mund të justifikohen nëse mbulohen nga staf i fushës së psikiatrisë sesa ndonjë fushë tjetër mësuesie.

- *Lidhur me komentimin që bëhet për pedagogun D.T., GVJ ka marrë në konsideratë se:*

Bazuar në takimin në institucion me pedagogët dhe me njësinë bazë opinionet e tyre ishin të paqarta dhe në thelb kjo tregon problematikën që egziston lidhur me faktin që egziston një mjedis ambivalent përse i përket faktit që të dhënat në dokumentacione janë paraqitur ndryshe dhe në praktikë realizohen ndryshe. Gjykojmë që institucioni duhet t’i marrë këto konstatime si moment reflektimi për të vendosur një ekuilibër të qëndrueshëm në mënyrën sesi mban qëndrueshmëri në stafin e angazhuar në procesin mësimor. Konstatimet tona bazohen në dokumentacionin zyrtarë të dorëzuar pranë ASCAL dhe duhet të rikujtojmë se këto janë dokumenta zyrtarë të cilën janë burimet materiale për të realizuar vlerësimin tonë.

Për sa argumentuam më lart raporti nuk ndryshon.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Psikologji Klinike”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti Privat “Albanian University” (AU) zotëron mekanizma të qartë në raport me funksionimin dhe organizimin e programit të studimit në përputhje me statutin e tij të brendshëm të riorganizuar ⁴⁹ të Senatit Akademik dhe rregullores së AU ⁵⁰ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ⁵¹ ; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁵² . Kjo është evidentuar edhe në Rregulloren e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme ⁵³ , si dhe atë të programit të studimit ⁵⁴ që mbështetet në misionin dhe qëllimet e tij dhe në linjë me nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” është në harmoni me misionin, objektivat kryesore të arsimit të lartë. Referuar statutit ⁵⁵ por edhe rregullores së njësisë bazë ⁵⁶ , dhe të programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike” ⁵⁷ ky program studimi respekton lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik dhe të studentëve, përmes një politike të brendshme që synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit

⁴⁹Statuti AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr.80-15. Dokumenti nr 13.

⁵⁰Rregullore e përgjithshme e AU. Dokumenti nr 11.

⁵¹Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”

https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁵²VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlor.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-01-2021).

⁵³Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Dokumenti nr 16.

⁵⁴Rregullore e programit të studimit Master Profesional. Dokumenti nr 18.

⁵⁵Statute AU i riorganizuar sipas Ligjit Nr. 80-15. Dokumenti nr 13.

⁵⁶Rregullore e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme. Dokumenti nr 16.

⁵⁷Rregullore e programit të studimit Master Profesional. Dokumenti nr 18.

	dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ⁵⁸ .			
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit është hartuar në frymën e kuadrit të ri ligjor dhe në përputhje me politikat e brendëshme të institucionit dhe nevojave social-ekonomike të vendit. Programi i studimit master profesional në “Psikologji Klinike” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e AU-së. Qëllimi dhe misioni i këtij programi janë të integruara në linjë me fushën e studimit brenda njësisë bazë të tij. Gjithashtu duke iu referuar kushteve specifike përsa i përket zhvillimit të profesioneve të reja, ky profil ka prespektivë të mirë punësimi si rezultat i fushës së gjerë të aplikimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi.			
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program studimi profesional është hartuar dhe ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës për profesionist të kualifikuar. Përmes dokumenteve të vëna në dispozicion nga institucioni dhe më specifikisht është bërë analizë e tregut të punës ⁵⁹ bazuar në shqyrtimin e të dhënave nga institucione të ndryshme mbi nevojat për psikologë klinik. Studentet e këtij profili mund të kontribuojnë në një sër kontekstesh profesionale përmes rolit të tyre si specialist i shëndetit mendor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përputhje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit master profesional në “Psikologji Klinike” është në linjë me strategjinë e zhvillimit institucional ⁶⁰ dhe synon konsolidimin e dijeve përmes respektimit të lirisë akademike dhe autonomisë së strukturave përkatëse në drejtim të mësimdhënies, kërkimit shkencorë dhe inovacionit si mjet për rritjen e cilësisë së shërbimit. Shqyrtimi i dokumentacionit të shfletuar për këtë program studimi është në harmoni të plotë me statutin dhe

⁵⁸Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <http://ëëë.akaftp.gov.al/ëp-content/uploads/2014/09/NIVELET-E-KORNIZ%C3%8BS-SHOIPTARE-T%C3%8B-KUALIFIKIMEVE.pdf> (Aksesuar më datë 07-01-2021).

⁵⁹Evidence R3. Dokumenti nr 8.

⁶⁰Plani strategjik institucional 2017-2022. Dokumenti nr 10.

	<p>rregulloren e institucionit. Ai gjithashtu shpalos më së miri strategjinë për zhvillimin e institucionit, në mënyrën sesi menaxhohen burimet njerëzore dhe të tjera burime që institucioni ka në dispozicion për konsolidimin e pozitave të tij.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” mund të konsiderohet prioritar në aspektin akademik duke iu referuar nevojës për të zhvilluar këtë fushë të re studimi e cila për hirë të së vërtetës në vendin tonë ka filluar të zhvillohet lirisht këto 2 dekadat e fundit. Nevojat për profesionistë janë të mëdha ashtu si edhe përgjegjësitë e institucioneve të arsimit të lartë që i ofrojnë këto programe janë të mëdha në raport me dijet dhe njohuritë që duhet t’iu ofrojnë studentëve. Referuar statutit dhe rregullores së institucionit ka një ambicje të qartë në drejtim të zhvillimit të vrullshëm inovativ në të gjitha drejtimit akademike, të cilat përthyhen në kontribut në drejtim të kërkimit shkencor dhe kontributit konkret në drejtim të prioriteteve të tij akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Mbështetur në të dhënat e vëna në dispozicion, konfirmojmë se emërtimi, organizimi struktura dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me fushat e drejtimit akademik të institucionit dhe strategjisë së tij për zhvillim. Gjithashtu referuar përmbajtjes së programit të studimit ka lehtësira për institucionin t’iu ofrohen studentëve mundësi mobiliteti me programe të tjera studimi si motra brenda dhe jashtë vendit (referuar Europsy⁶¹. Bazuar në emërtimin por edhe në përmbajtjen e programit i kanë dhënë mundësinë që të konsolidohet si program dhe ta ketë të lehtë marrjen e liçencës nga Urdhrit të Psikologut në përfundim të studimeve.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Bazuar në karakterin profesional të këtij program studimi dhe nevojave për psikologë klinik në shumë sektor të rëndësishëm, hartimi dhe zhvillimi i programit të studimit jep një kontribut të drejtpërdrejt në fushën e edukimit dhe të mbështetjes së shoqërisë. Kjo lidhur me rolin e psikologut klinik si një profesionist i shëndetit mendor që mbështet dhe ndihmon në orientimin e individit dhe të grupeve vulnerabël në fitimin e ndërgjegjësimit dhe rrijtes së efikasitetit në planin personal dhe shoqëror. Në kushtet aktuale të përballjes me pandeminë globale roli i këtyre programeve studimi me drejtim human, na jep mundësinë të gjithëve të mund të edukohemi me vlerat e larta të respektit për dinjitetin, integritetin dhe kompetencat profesionale për t’i shërbyer shoqërisë ku bëjmë pjesë.</p>

⁶¹Lunt I., Peiró J. P., Poortinga Y., Roe R. (2014) Standards and Quality in Education for Professional Psychologists; Hogrefe.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” synon formimin e kompetencave dhe shprehive praktike që do t’i lejojnë studentët të orientohen lehtësisht drejt rolit të tyre profesional. Objektivat e tij janë të përcaktuar qartë në planin e tij mësimor⁶² përmes lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin e kompetencave teoriko-praktike që i përgjigjen nevojave të profilit profesional. Por edhe në rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë objektivat akademik që synojnë t’i japin këtij program studimi me karakter profesional dije dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes psikologjike. Kjo në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁶³, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁶⁴ si dhe nevojat e tregut të punës për psikolog klinik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me</p>	<p>Studimi i tregut të punës dhe ndjekja e studentëve të këtij masteri profesional pas përfundimit të studimeve⁶⁵ synojnë të mbajnë institucionin në kontakt të vazhdueshëm me punëdhënësit dhe punëmarrësit. Një studim periodik i tregut të punës⁶⁶ është kryer nga institucioni me qëllim vlersimin e hapsirave dhe mundësive që psikologët klinik kanë në institucione të ndryshme. Metodologjia e studimit e bazuar në analizën e dokumentacionit dhe statistikat e institucioneve që kanë në organikën e tyre</p>

⁶²Plani mësimorë. Dokumenti nr 15.

⁶³Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁶⁴VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf> (Aksesuar më 08-01-2021).

⁶⁵Rregullore e Zyres së Karrierës dhe Alumnit. Dokumenti nr 49.

⁶⁶Evidenca R 3. Dokumenti nr 8.

<p>punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>psikologë klinik si dhe monitorimi i shpalljeve për vende vakante për pozicionin e psikologut klinik, ka dhënë rezultate të kënaqshme mbi sferën e gjerë ku mund të punësohet një student i cili përfundon studimet në profilin klinik.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Ky program studimit udhëhiqet nga parimi i zhvillimit të kompetencave profesionale dhe kjo shpaloset edhe në mënyrën sesi është hartuar programi. Gjithashtu referuar mënyrës sesi do të realizojë formimin e studentit të profilit të psikologjisë klinike në drejtim të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale ka një sër strukturash ku mund të mbështetet sic janë plani mësimor i cili duhet parë si themelet e formësimit profesional të studentit dhe për këtë është e rëndësishme një thellim në dije, njohuri e aftësi specifike të lidhura me rolin e psikologut klinik. Njohuritë teorike dhe përvojat praktike do të lejojnë më pas një profilizim në përputhje me prirjet, kompetencat dhe interesat profesionale të studentit, gjë të cilën programi parashikohet ta ketë të mundur ta realizojë. Në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale dhe përfitimit të përvojës së praktikës profesionale, me ndikim pozitiv duhen parë si marrëveshjet e lidhura nga institucione me qendra dhe klinika⁶⁷ ku ofrohen shërbime psikologjike por edhe pasja aktive e një zyre këshillimi psikologjik⁶⁸ pranë AU për nevojat e studentëve studentët dhe komunitetin.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e programit lëndorë dhe tipologjinë e lëndëve të formimit karakterizues dhe integruese, duke lehtësuar procesin e mobilitetit, transferimit dhe njësimit të diplomës edhe në tregun ndërkombëtarë, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë janë të ngjashme me programe të tjera të ofruara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu bazuar në programet e mobilitetit të cilat janë aktive në Bashkimin Evropian, studentët e këtij programi studimi mund të përfitojnë në drejtim të mundësive për transferim studimesh apo për punësim në tregun ndërkombëtar, me të njëjtat mundësi si për çdo institucion tjetër të arsimit të lartë në vendin tonë. Në thelb ky program studimi përmes lëndëve dhe moduleve synon paisjen e studentit me njohuri dhe kompetenca që janë të ngjashme me atë që mund të marrë një student edhe nga institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend për këtë profil profesional.</p>

⁶⁷Evidenca R2. Dokumenti nr 7.

⁶⁸Zyra e këshillimit psikologjik. Dokumenti nr 14.

<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Bazuar në mungesën e përvojës në drejtim të zhvillimit të shkencës së psikologjisë në vendin tonë para viteve 90, duhet të kemi parasysh se programet lëndore tipikish përgjatë gjithë historisë së zhvillimit të kësaj disipline janë bazuar dhe kanë evoluar duke u mbështetur në programet ndërkombëtare dhe duke marrë si model zhvillim, qasjen që këto vende kanë pasur ndaj psikologjisë. Në këtë kuadër përgjithësisht programet e studimit në këtë fushë kanë ngjashmëri një drejtim të programit lëndorë dhe objektivate formuese e kompetencave profesionale që synojnë të zhvillojnë. Gjithashtu një sër elementësh të strukturës së këtij program studimi si kreditet sipas Sistemit Evropian të Trasferimit të Krediteve (ECTS), kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlersimit, profili i programit, diploma dhe suplementi i saj etj, janë të gjithë element të pranishëm që janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” ofrohet me kohë të plotë, i shtrirë në një vit akademik me kohëzgjatje normale dhe organizohet me 60 ECTS. Bazuar në programin lëndorë dhe planin mësimorë të këtij programi, studentëve u mundësohet përvoja e praktikës profesionale e cila mund të kryhet në disa qendra dhe institucione publike dhe private në vend. Kjo përzgjedhje e institucioneve të praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë kompetencat profesionale, fitojnë dije praktike mbi mjetet dhe instrumentat që përdor psikologu klinik në punën e tij. Gjithashtu ky profil profesional i ofruar nga AU i përfshirë në grupin e profesioneve të rregulluara nga shteti, u jep mundësi studentëve të licensohen te Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Aktivitetet ekstra kurrikulare dhe qendra e shërbimeve psikologjike i japin mundësi shumë të mira studentëve për të qenë në kontakt me përvojën klinike dhe mënyrën sesi ofrohen shërbimet psikologjike për palë të tjera. Gjithashtu përmes këtyre mundësisve studentët e këtij program studimi mund të njohin më mirë terrenin e punës për psikologët klinik, sfidat dhe vështirësitë me të cilat përballen përgjatë ushtrimit të profesionit.</p>
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj</p>	<p>Ky program studimi MP në “Psikologji Klinike” me kohë të plotë, i organizuar me 60 ECTS ofrohet në gjuhën shqipe. Duke iu referuar synimeve të institucionit për të përthithur student nga trojet shqiptare, procedurat dhe kriteret e pranimit lejojnë cdo student të interesuar për t’u bërë pjesë e këtij mastri profesional. Nuk kemi evidenca për të gjykuar mbi përfshirjen e elementeve</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

16



me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	të mësimdhënies, moduleve, lëndëve në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj. Vlen të theksohet se në vendin tonë në përgjithësi programet që ofrojnë element në programin e studimit në gjuhë të huaj nuk kanë një shritje të gjerë, në këto kushte përmbushja e këtij kriteri duhet vlersuar bazuar në kontekstin e vendit dhe avancimit të institucioneve të arsimit të lartë drejt standarteve ndërkombëtare.								
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Referuar te dhënave të marra gjatë vizitës në institucion mbi studentët që kanë ndjekur këtë master profesional ndër vite, evidentojmë se një numër i madh studentësh kanë qenë në marrëdhënie pune. Këto student kanë ushtruar rolin e psikogut klinik në institucione të ndryshme Brenda vendit tonë apo nga Kosova. Motivacionet për nisjen e këtij masteri janë të lidhura me zhvillimin e kompetencave profesionale dhe ruajtjen e vendit të punës.								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Bazuar në të dhënat e institucionit mbi stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie dhe duke iu referuar CV të tyre mund të gjykojmë se ky kriter pjesërisht përmbush nevojat e programit për kapacitete dhe burime konform fushës akademike specifike. Gjithsesi duke qenë një profil klinik, duhet parë me kujdes përfshirja e stafit akademik për të mbuluar lëndë e module të ndryshme. Kualifikimet e pjeseshme dhe të shkurtra në fushën e psikologjisë nuk të shndërrojnë në psikolog klinik, dhe as nuk të lejojnë liçensimin nga Urdhri i Psikogut. Nëse një lektor nuk përmbush kushtet për liçensim nuk mund të formojë breza psikologësh klinik.</p> <p><i>Referuar (RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat vulosur., tabela nr.1) Fakulteti i Shkencave Shoqërore për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej 107 pedagogë, nga të cilët 38 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 23 kanë gradën Dr., dhe 11 Asistent Lektorë me Msc; dhe 69 pedagogë me kontratë (PAK)</i></p>

	<p>nga ku 7 kanë titullin “Profesor”, 11 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 30 kanë gradën Dr. dhe 21 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Ndërsa Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka 10 PAE dhe 23 PAK.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në këtë vit akademik, sipas evidencës (RVB MP. Psikologji Klinike tabela nr.6.1), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 7 pedagogë gjithsej, ku 6 PAE, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 3 me gradën Dr, si edhe 2 asistente-lektore me Msc, dhe 1 PAK me titullin Prof.Asoc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 86% me 14%.</p> <p>Ndërsa për vitin akademik 2020 - 2021, sipas evidencës (Ngarkesa e programit sem 1,2), kërkuar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 6 pedagogë gjithsej, ku 5 PAE, nga të cilët 1 Prof.Asoc, 3 me gradën Dr, si edhe 1 asistente-lektore me Msc, dhe 1 PAK me titullin 1 Prof.Asoc.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezulton 83% me 17%.</p> <p><i>Rekomandohet nga GVJ, që njësia bazë por edhe strukturat e tjera pranë institucionit përgjegjëse për monitorimin e cilësisë të jenë të kujdeshëm në mënyrën sesi shpërndahet ngarkesa mësimore dhe përzgjidhet stafi akademik që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi me një profil specifik në psikologji klinike.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi është në përputhje me kushtet dhe kriteret klasifikuese të fushës akademike kjo referuar udhëzimeve kombëtare për arsimin e lartë. Programi i studimit master professional në “Psikologji Klinike” ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas</p>	<p>Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka një koherencë me vizionin dhe strategjinë afatgjatë të institucionit përsa i përket përputhjes me fushën akademike dhe kërkimit shkencor, si dhe është një linjë me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane. Kjo i jep mundësinë njësisë bazë, Departamentit të</p>

<p>klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Psikologjisë së Përgjithshme, të ketë mundësi në rritje për zhvillimin e burimeve njerëzore në funksion të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu bazuar në klasifikimin/kodifikimin e programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” ky profil i ofruar nga AU është në harmoni me dhe në përputhje me statutin e tij të brendshëm të riorganizuar⁶⁹ Senatin Akademik dhe rregullores së AU⁷⁰ e hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁷¹; VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”⁷².</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky është një program i fushës së Shkencave Shoqërore, i cili ofrohet nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, pra ofrohet brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë bazë dhe kryesore. Ka një harmoni me fushën e shkencave shoqërore dhe në linjë me profilin e njësisë bazë që ofron programin e studimit master profesional në “Psikologji Klinike”.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron</p>	<p>Institucionit vërehet të ketë një hierarki të strukturuar^{73,74,75}; ⁷⁶sipas hallkave, të cilat monitorojnë përmes mekanizmave të saj mbarëvajtjen e punës në drejtim të realizimit të detyrave nga ana</p>

⁶⁹Statuti AU I riorganizuar sipas Ligjit Nr.80-15. Dokumenti nr 13.

⁷⁰Rregullore e përgjithshme e AU. Dokumenti nr 11.

⁷¹Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁷²VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>(Aksesuar më 08-01-2021).

⁷³Statuti AU I riorganizuar sipas Ligjit Nr.80-15. Dokumenti nr 13

⁷⁴Rregullore e përgjithshme e AU. Dokumenti nr 11

⁷⁵Plani strategjik institucional 2017-2022.

⁷⁶Rregullore e Departamentit të Psikologjisë.

<p>marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Njësia bazë përmes strukturave të saj kordinatori i programit të studimit⁷⁷, grupit mësues mbikqyrin, monitorojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre për qëllime të mbarëvajtjes të procesit mësues për këtë program studimi. Një sërë dokumentash e përligjin bashkëpunimin brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive^{78,79,80,81} e personelit^{82, 83, 84}. Kjo vërehet duke iu referuar edhe dokumentacionit vënë në dispozicion mbi organizimin dhe funksionimin e dekanatit dhe departamentit, rregullorja mësuese e programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” e sekretaria mësuese.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësues e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga AU dhe të konfirmuar në takimet e zhvilluara me drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë por edhe nga student, kemi praninë e një sërë marrëveshjes institucionale të lidhura si me institucione brenda vendit por edhe me institucione ndërkombëtare. Vlen të theksohet edhe shfrytëzimin i këtyre marrëveshjeve për qëllime të praktikave profesionale dhe mundësive për mobilitet të studentëve të AU. Marrëveshjet e bashkëpunimit të AU-së me institucionet homologe jashtë vendit janë kthyer në aplikative në aktivitetet e përbashkëta të ndërmara drejtim të kërkimit shkencor si konferencat, workshop-et, leksionet e hapura të zhvilluara pranë këtij institucioni^{85, 86, 87}. Në bazë të këtyre evidencave gjykohet se kjo klimë ka impakt pozitiv dhe në realizimin e objektivave të procesit mësues e formues të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike,</p>	<p>Në funksion të praktikës profesionale⁸⁸ institucioni ka nënshkruar një sërë marrëveshjes bashkëpunimi. Këto marrëveshje me disa institucione kyçe për profilin e psikologut klinik si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë klinike si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunktionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”,</p>

⁷⁷Kordinator Programi.

⁷⁸VI.7. Rregullore për mbarëvajtjen e Kurrikulave.

⁷⁹V.1. Rregullore e Zyres së kordinimit dhe mbështetjes së studentëve.

⁸⁰V.2. Rregullore e Zyres së karrierës dhe alumni.

⁸¹Rregullore e Rregjistrimeve dhe Trasferimeve

⁸²VI.1 VS- ngritja e ZSBC.

⁸³VI.2 VS- ngritja e KVI.

⁸⁴VI.6. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

⁸⁵III.4.a Trajnime 2019-2020.

⁸⁶III.4.b Trajnim personeli me prof. të huaj.

⁸⁷III.7. Lista e aktiviteteve 2019-2020.

⁸⁸Evidencë R2.

<p>praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”⁸⁹ etj, krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e mundësive për të realizuar eksperiencë pune vulnetare. Përvoja praktike në terrenin e punës krijon mundësi për njohjen reale të mjediseve të ndryshme profesionale në fushën e psikologjisë klinike. E gjithë kjo përkthehet në mundësi për studentët për të njohur rolin dhe detyrat e psikologut në kontekste të ndryshme profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Marrëveshje e bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyçe për profilin e psikologut klinik. Institucione si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë klinike si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”⁹⁰ etj, krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencë pune vulnetare apo punë sipas nevojave të institucioneve që ofrojnë shërbimeve psikologjike për komunitetin.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Referuar listës së aktiviteteve të realizuara nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme përgjatë vitit 2019-2020⁹¹, kemi një sërë aktiviteteve si leksione të hapura me profesor të ftuar vendas dhe të huaj, workshop-e, tryeza të rumbullakta, aktivitete bamirësie që janë me përfitim për studentët e programit të studimit MP në “Psikologji Klinike”. Gjithashtu në drejtimin e trajnimeve profesionale të ofruara për stafin e AU, studentët dhe alumnit (ish student) kanë marrë pjesë në aktivitetin dy ditorë GRADUA, të financuar nga Erasmus +. Ky aktivitet kishte si qëllim trajnimin për përdorimin e Platformës Gradua e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Platforma të ndihmon të krijosh një CV të tyre personale, të kenë qasje të lehtë në</p>

⁸⁹Raporti vjetor 2019-2020.

⁹⁰Raporti vjetor 2019-2020.

⁹¹Lista e aktiviteteve 2019-2020.

	informacion mbi mundësitë e punësimit, ofertave të punës nga kompanitë dhe praktikës profesionale.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Njësia bazë përmes strukturave të saj monitoron në vijimësi ecurinë e përgjithshme të programit të studimit përmes disa formave monitoruese si analizës së raportit të vetvlersimit ⁹² të programit, analizës së pyetësorëve të realizuar me stafin ⁹³ dhe studentëve por edhe përmes strukturave të saj për monitorimin e cilësisë së veprimtarive teoriko-didaktike dhe praktikë që ofrohen prej saj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MP në “Psikologji KLinike” është hartuar në harmoni me legjislacionin vendas siç janë: Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ⁹⁴ dhe VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” ⁹⁵ , dhe duke respektuar Sistemin Evropian të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ETCS). Kemi balancë në ndarje të lëndëve në lëndë të formimit bazë,

⁹²Model raporti vetvlersimi program.

⁹³Analizë e pyetësorit.

⁹⁴Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri”https://archive.org/stream/LIGJI802015PERARSIMINELARTEDHEKERKIMINSHKENCORFLETORJAEBOTIMEVEZYRTARE/LIGJI+80+2015+PER+ARSIMIN+E+LARTE+DHE+KERKIMIN+SHKENCOR+FLETORJA+E+BOTIMEVE+ZYRTARE_djvu.txt (Aksesuar më 08-01-2021).

⁹⁵VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>(Aksesuar më 08-01-2021).

	<p>karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse sipas udhëzimeve të MASR.</p> <p>Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” realizohet me 60 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tij është 1 vit akademik, i ndarë në dy semestra me peshën e fitimit të 30 krediteve për semestër. Në përfundim të programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” lëshohet diploma “Master Profesional” në fushën "Psikologji Klinike".</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” përmes moduleve⁹⁶ dhe lëndëve⁹⁷ synon të formojë shprehi dhe kompetenca në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes në kontekstin klinik. Kjo në një llojshmëri të gjerë rolesh profesionale si psikolog klinik si në drejtim të zhvillimit të shprehive profesionale për të punuar me fëmijët dhe adoleshentët, me klientët e rritur të cilët kanë probleme të shëndetit mendor, por gjithashtu edhe si këshilluese në institucione rezidenciale ku marrin shërbime kategori vulnerabël të shoqërisë tonë. Pikërisht rritja e diapazonit të mundësive që u krijohen studentëve në fushën profesionale mund të konsiderohet si pikë e fortë e këtij program studimi për të pasur më të lehtë orientimin e studentëve në tregun e punës por edhe drejt vetëpunësimit të tyre. Vetpunësimi është i mundur vetëm pas liçensimit, por formimi akademik përmbush kritert e udhrit të psikologut për liçensim të studentëve të këtij program studimi pas marrjes së diplomës për të gjithë ata student që kanë të dy ciklet e studimit në fushën e psikologjisë.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Referuar këtij kriteri mund të themi se përmbajtja e programeve lëndore dhe literature e përdorur janë dy element të rëndësishëm në drejtim të njohurive të përparuara për këtë fushë studimi dhe më tej në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve. Sugjerohet që ky element të shihet me kujdes nga njësia bazë dhe stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie. Rekomandohet angazhim më i madh nga stafi akademik në procesin e përditësimit të literaturës bazë dhe asaj ndihmëse të syllabuseve të lëndëve mësimore që ato japin, me literaturë të nevojshme për të mbuluar nevojat për të qenë në kontakt me risitë e fundit të zhvillimit brenda fushës. Njësia bazë duhet të mbështes stafin me infrastrukturën e duhur me tekste fizike që mund të aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët. Pavarësisht faktit që institucioni ka askese në disa platforma</p>

⁹⁶Syllabuset.

⁹⁷Plani mësimor.

	<p>elektronike të literaturës, kjo nuk garanton në të gjitha rastet publikime cilësore dhe akses në revista e libra me indeks të lartë.</p> <p><i>GVJ del me këto rekomandime të përgjithsme për këtë kriter si monitorimi nga njësia bazë i përditësimit të literaturës për secilën lëndë mësimore, njësia bazë duhet të mbështes stafin me infrastrukturë në tekste fizike në bibliotekë, si dhe impenjim më i madh i stafit për të përditësuar literaturën bazë me botime të 5 viteve të fundit.</i></p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit master profesional në “Psikologji Klinike” është konform pritshmërive të studentëve për të zhvilluar kompetencat profesionale në drejtim të njohurive teoriko-praktike për të punuar si psikolog klinik pas përfundimit të masterit. Gjithashtu drejtimi i secilës lëndë përmban një sër veprimtarish praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin praktik të koncepteve teorike nga ana e studentit. Përvoja e praktikës profesionale është organizuar në mënyrë që t’u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës. Megjithatë mënyra sesi do të implementohet në kontekstin e mësidhënies nga ana e lektorit që zhvillon lëndën mësimore ⁹⁸do të varet nga vizioni dhe të kuptuarit e informacionit nga prespektiva e një psikologu klinik.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Syllabuset e master profesional në “Psikologji Klinike” janë konform modelit të përcaktuar nga MASR në shtojcën e vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018. “Për Elementët e Programit të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Syllabuset e secilës lëndë janë të organzuara sipas strukturës së më poshtë me: përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, objektivat dhe konceptet themelore, temat e lëndës dhe secila prej tyre përmbajnë një sër veprimtarishë praktike që realizohen si pjesë e seminareve duke lehtësuar në këtë mënyrë përvetësimin e koncepteve teorike nga ana e studentit. Silabusi i praktikës është organizuar në mënyrë që t’u jap mundësi studentëve të përfitojnë kompetenca dhe njohuri praktike nga prekja e terrenit të punës.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas</p>	<p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë⁹⁹ dhe urdhrave¹⁰⁰ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me</p>

⁹⁸CV. P.L. (dokumenti lidhur me cv e lektorit të disa prej lëndëve me karakter thellësisht profesionale në profilin psikolog klinik).

⁹⁹Dokumenti 181. Ligji nr 802015 Për Arsimin e LArtë.

¹⁰⁰Dokumenti 189. Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Për akreditimin e disa programeve të studimit në Ba, MSH, MP.

<p>kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A e lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisciplinore / Integruese 27 % (ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (ECTS); <p>Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018)¹⁰¹, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara sipas Vendimit Nr. 41, datë 24.01.2018)¹⁰², duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar (<i>Evidenca II.1. Plani mesimor.pdf</i>), GVJ konstaton se ky program studimi parashikon për praktikën profesionale 120 orë të zhvilluara në auditor dhe 30 orë punë individuale e pavarur e studentit, pra 150 orë pune në total që korrespondojnë me 6 kredite CTS (1 kredit=5 orë).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore, si njësi kryesore e organizuar sipas ligjeve për organizimin akademik dhe administrative të institucioneve të arsimit të lartë ka si pjesë të saj njësinë bazë përgjegjëse, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme.</p>

¹⁰¹Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

¹⁰²Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.




ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Mësohet nga takimi me përgjegjësen e Departamentit dhe antarë të departamentit se njësia bazë ngre grupin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi sipas detyrimeve ligjore për funksionimin normal të tij, si dhe në linjë me statutin dhe rregulloren e institucionit. Kjo njësi përmbush kushtet për vijimin e procesit të vlerësimit dhe akreditimit për këtë program studimi, duke iu referuar ndjekjes së procedurës pranë ASCAL duke respektuar ligjet në fuqi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë” sipas propozimit të përgjegjësit të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Dr. D. T. ¹⁰³ . Njësia kryesore është organizuar në 4 departamente. Njësia bazë që e ofron MP në “Psikologji Klinike” është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Përsa i përket kualifikimit dhe titujve akademik përgjithësisht stafi përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik. Raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme përmbush kushtet bazë për tu angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi. Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 86% me 14%. <i>Referuar (RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat vulosur., tabela nr.1)</i> Fakulteti i Shkencave Shoqërore për vitin akademik 2019-2020 ka gjithsej 107 pedagogë , nga të cilët 38 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku: 1 ka titullin “Profesor”, 3 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 23 kanë gradën Dr., dhe 11 Asistent Lektorë me Msc; dhe 69 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 7 kanë titullin “Profesor”, 11 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 30 kanë gradën Dr. dhe 21 Asistent Lektorë me Msc. Ndërsa Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka në përbërjen e tij gjithsej 33 personel akademik , nga ku 10 personel akademik efektiv (PAE) , nga të cilët 1 Prof. Asoc. Dr., 5 Dr. dhe 4 asistentë lektorë, dhe 23 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët 2 Prof.Dr., 2 Prof.Asoc., 12 me gradë shkencore Dr. dhe 7 Asistent Lektorë me Msc.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet	Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të

¹⁰³Il. 3. Kordinator i programit.

<p>ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë.</p> <p>Referuar (RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat vulosur, tabelat nr. 2 dhe 2.1) stafi akademik i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme që është përgjegjës për programin e studimit në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020, (10 PAE/ 23 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 6 / 16;</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 në funksion të organizimit dhe strukturës akademike janë angazhuar 7 anëtarë të personelit akademik efektiv, nga të cilët 6 me grada dhe tituj. Ngarkesa e mbuluar përmes personelit akademik efektiv ka qenë në masën 90%, nga 70% referuar minimumit të kërkuar nga standardi i cilësisë dhe përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Kjo evidencë na lejon krijimin e një panorame të qartë të situatës për periudhën aktuale dhe projektimin e saj në vijimësinë e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Përvoja praktike ka një infrastrukturë që i lejon të jetë efikase në raport me përvetësimin e njohurive praktike si rrjedhojë e kordinimit të mirë që njësia bazë ka bërë në drejtim të marrëveshjeve institucionale për nevojat e praktikës profesionale për këtë program studimi dhe të monitorimit nga pedagogu udhëheqësi i praktikës. Nevoja për të qenë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme në lidhje me ofrimin e shërbimeve psikologjike personave që u përkasin kategorive vulnerabël të cilët e kanë të pamundur të përballen me problemet e shëndetit mendor, përbëjnë një kusht të domosdoshëm për këtë program studimi profesional. Studentët e këtij programi studimi gjatë përvojës praktike kanë mundësi të pajisen me kompetencat e duhura në drejtim të vlersimit dhe ndërhyrjes psikologjike duke ofruar mbështetje psiko-emocionale dhe lehtësim në drejtim të veprimarive konkrete për kujdesin për veten, fuqizimit personale, ndërmjetësimin për të marrë shërbimet e nevojshme sociale dhe komunitare sipas nevojave të personave.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe</p>	<p>Mënyra si funksionon njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”, sipas propozimit të përgjegjës të Departamentit miraton në rolin e kordinatorit për këtë program studimi Dr. D. T.¹⁰⁴. Përgjegjësitë e kordinatorit të</p>

¹⁰⁴||. 3. Kordinator | programit.



zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” rregullohen edhe përmes objektivave formuese të programit të lëndës. Roli i kordinatorit lehtëson në aksesin e informacionit për studentët dhe për pedagogun e praktikës në lidhje me terenet e mundshme të shfrytëzueshme nga studentët e këtij program studimi për praktikën profesionale por edhe përmes angazhimit të studentëve në një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare të organizuara në rang departamenti apo fakulteti.			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i programit referuar informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion realizohet në vijimësi. Ai raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse, por dokumenton në lidhje me çdo informacion që lidhet me programin e studimi nuk na u vendos në dispozicion. <i>Rekomandimet tona si GVJ në lidhje me këtë aspekt parashtrajnë nevojën e dokumentimit të rolit dhe punës së kordinatorit te drejtuesi i njësisë bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga takimet me dekanin e institucionit, përgjegjësen e departamentit dhe zyrat përkatëse të ZBNj apo edhe ZNjSBC, mësohet se protokollet e institucionit dhe burimet njerëzore e materiale në funksion të organizimit të këtij programi duket se i japin mundësi institucionit të avancojë në drejtim të realizimit të tij konform rregullave që i lejojnë funksionimin normal.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Ky program studimi është organizuar konform rregullores së programit dhe përcaktimeve ligjore në fuqi duke respektuar ndarjen e veprimtarive formuese sipas tipit të komponentëve mësimor në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, lëndë plotësuese (praktika) dhe detyrime përmbyllëse. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithsme ka një hierarki në mënyrën e funksionimit të tij dhe kjo konform udhëzimeve të

	MASR dhe konform rregullave që monitorojnë aspektin e ligjshmërisë.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Përsa i përket përmbajtjes së planit mësimor ai është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respektimit të standarit për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik, një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p>Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimorë janë konform ligjit për arsimin e lartë¹⁰⁵ dhe urdhrave¹⁰⁶ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A tipi i Lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (ECTS); - Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (ECTS); - Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinore / Integruese 27 % (ECTS); - Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (ECTS); - Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (ECTS); <p>Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018)¹⁰⁷, duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e	Programi i studimit master profesional në “Psikologji Klinike” ka një informacion të detajuar konform rregullave në fuqi dhe një shpërndarje të qartë të planit mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, kreditet dhe ndarjen sipas

¹⁰⁵Dokumenti 181. Ligji nr 802015 Për Arsimin e Lartë.

¹⁰⁶Dokumenti 189. Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Për akreditimin e disa programeve të studimit në Ba, MSH, MP.

¹⁰⁷Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

<p>programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>semestrave akademike. Në funksion të këtij procesi është dhe rregullorja e këtij program studimi, në të cilën specifikohen rregullat e frekuentimit të procesit mësimor dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>AU ka të specifikuar në rregulloren mësimore për programin e ciklit të dytë të studimit MP në “Psikologji Klinike” kriteret që duhet të plotësohen për t’u pranuar në programin e studimit.</p> <p>Kjo rregullore mësimore e programit të studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Institucioni përmes njërive të saj monitoron respektimin e kriterëve të përgjithshme dhe specifike¹⁰⁸ të pranimit në këtë program studimi si dhe procedurat e ndjekura në pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e programit të studimit bazuar në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve të AU-së¹⁰⁹.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Lidhur me procedurat që ndjek institucioni në drejtim të realizimit të programit të studimit kemi një informacion të pasur me të dhëna që rregullojnë punën në drejtim të hartimit të syllabuseve të lëndëve sipas ligjeve shtetërore dhe sipas formatit të miratuar nga MASR, dhe i njëjti drejtim ndiqet edhe nga rregullorja mësimore e programit të studimit, e cila përcakton parimet e përgjithshme për këtë program studimi.</p> <p>Programet lëndore përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018¹¹⁰, gjithashtu duke iu referuar planit mësimorë,¹¹¹ kemi një ndarje të lëndëve mësimore në semestra duke respektuar peshën e ngarkesës në semestra dhe duke ruajtur numrin e krediteve për çdo semestër akademik. Problematika shfaqet referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, ku rezulton se lektori D.T.¹¹² është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore¹¹³; ¹¹⁴; ¹¹⁵ dhe gjithashtu</p>

¹⁰⁸II. 4. Rregullorja e programit të studimit Master Profesional

¹⁰⁹II. 6. Rregulloren e Regjistrimeve dhe Transferimeve-25.06.2020.

¹¹⁰VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”<https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>(Akseluar më 08-01-2021).

¹¹¹II.1. Plani mësimor.

¹¹²CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

¹¹³Intervista klinike. Dokumenti nr 22.

¹¹⁴Psikoterapitë në praktikën klinike. Dokumenti nr 28.

¹¹⁵Sistemet aktuale diagnostike. Dokumenti nr 29.

	<p>P.L.¹¹⁶ është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore^{117, 118, 119, 120}. Kujtojmë se duke iu referuar planit mësimorë të programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike”¹²¹ numri i lëndëve përfshirë dhe temën e diplomës është në total 10 lëndë mësimore, ku 8 prej tyre mbulohen nga 2 lektore, 4 lëndë mësimore për secilin. Bazuar në këto të dhëna shihet me dyshim jo vetëm përmbushja e këtij rekomandimi por edhe rreziku i cënimit të cilësisë në mësimdhënie, ku një profesionist mbulon njëherësh një sër lëndësh. Kjo situatë bëhet më e paqartë nëse profili profesional i titullarit/ lektorit nuk i përket profilit klinik¹²².</p> <p><i>GVJ rekomandon të tregohet kujdes në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve dhe llojit të profilit që mbulon secili pedagog.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përsa i përket programit të studimit PM në “Psikologji Klinike” ky program është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë. Duke iu referuar të dhënave që u shqyrtuan nga GVJ, në programin e lëndëve evidentohen disa të dhëna kontradiktore përsa i përket stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë është në masën 90 %. Por kemi një sër të dhënash kontradiktore lidhur me angazhimin e stafit akademik në procesin mësimorë të këtij program studimi. Dokumentacioni përmban CV-të e 6 prej pedagogëve të cilët janë angazhuar në mësimdhënie në MP “Psikologji Klinike”, A.Ç.¹²³ staf akademik me kohë të</p>

¹¹⁶CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

¹¹⁷Konceptimi dhe analiza e rasteve klinike. Dokumenti nr 23.

¹¹⁸Praktikë Profesionale. Dokumenti nr 24.

¹¹⁹Psikologji Pozitive. Dokumenti nr 26.

¹²⁰Vlersimi dhe testimi psikologjik. Dokumenti nr 30.

¹²¹Plani mësimor. Dokumenti nr 15.

¹²²CV P. L. Dokumenti nr 66.

¹²³CV A. Ç. DOKUMENTI NR 62.

	<p>pjesëshme, B.L.¹²⁴, D.T.¹²⁵, I.H.¹²⁶, P.L.¹²⁷ si dhe S. I.¹²⁸ janë staf akademik me kohë të plotë. Për E. I. nuk është vënë në dispozicion një CV dhe as nuk figuron tek syllabuset si lektore për ndonjërin prej lëndëve mësimore për MP “Psikologji Klinike” edhe pse është pjesë e listës emërore të dërguar nga AU lidhur me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”¹²⁹. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një mospërputhje midis Cv-ve të dërguar për stafin akademik i cili është angazhuar në këtë program studimi, listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”¹³⁰ dhe lektorit që e realizon ngarkesën në auditor. Konkretisht tre lektorët I.H.¹³¹; E. I. dhe S. I.¹³² nuk rezultojnë të përfshira në syllabuset e lëndëve që realizohen në MP. “Psikologji Klinike”. Gjithashtu ndeshemi me një tjerët paqartësi, ku duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se lektori D.T.¹³³ është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore^{134, 135, 136} dhe gjithashtu P.L.¹³⁷ është aktualisht lektor për 4 lëndë mësimore^{138, 139, 140, 141}. Kujtojmë se duke iu referuar planit mësimorë të programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike”¹⁴² numri i lëndëve përfshirë dhe temën e diplomës është në total 10 lëndë mësimore, ku 8 prej tyre mbulohen nga 2 lektore, 4 lëndë mësimore për secilin. Bazuar në këto të dhëna shihet me dyshim jo vetëm përmbushja e këtij rekomandimi por edhe rreziku i cënimit të cilësisë në mësimdhënie, ku një profesionist mbulon njëherësh</p>
--	---

¹²⁴CV B. L. DOKUMENTI NR 63.

¹²⁵CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

¹²⁶CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹²⁷CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

¹²⁸CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

¹²⁹Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

¹³⁰Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

¹³¹CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹³²CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

¹³³CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

¹³⁴Intervista klinike. Dokumenti nr 22.

¹³⁵Psikoterapitë në praktikën klinike. Dokumenti nr 28.

¹³⁶Sistemet aktuale diagnostike. Dokumenti nr 29.

¹³⁷CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

¹³⁸Konceptimi dhe analiza e rasteve klinike. Dokumenti nr 23.

¹³⁹Praktikë Profesionale. Dokumenti nr 24.

¹⁴⁰Psikologji Pozitive. Dokumenti nr 26.

¹⁴¹Vlersimi dhe testimi psikologjik. Dokumenti nr 30.

¹⁴²Plani mësimor. Dokumenti nr 15.



	<p>një sër lëndësh. Kjo situatë bëhet më e paqartë nëse profili profesional i titullarit/ lektorit nuk i përket profilit klinik¹⁴³.</p> <p><i>Në linjë me profilizimin GVV sugjeron, që pedagogët që mbulojnë lëndët karakterizuese të programit, të kenë një vijimësi në të dyja apo trija ciklet e studimit brenda profilit të psikologjisë klinike. Sugjerohet të tregohet kujdes në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve dhe llojit të profilit që mbulon secili pedagog.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënljore në fuqi.	Ngarkesa e programit të studimit reflekton një koherencë me parashikimet e akteve ligjore referuar numrit të krediteve, 60 kredite, kohëzgjatjes normale të tij në 1 vit akademik, tipologjisë së lëndëve sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin duke u mbështetur në VKM.Nr. 41, dt.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, dhe legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në Statutin dhe Rregulloren e AU-së.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit MP në “Psikologji Klinike” mbështetet në VKM Nr. 41, dt.24.01.2018, mund të krijoj kushte të favorshme në drejtim të përfitimit të njohurive, aftësive, licensimit dhe punësimit për profilin e studimit psikolog klinik, pasi përmbajtja e veprimtarive dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë të arrihet një profilizim që të jep mundësi të punosh brenda fushës së psikologjisë klinike. Shpërndarja e lëndëve i jep mundësi studentit të marrë njohuri nga disiplina të psikologjisë klinike, praktika gjithashtu bazuar në mënyrën e organizimit dhe tematikave që prek, referuar silabusit të lëndës të japin mundësi

¹⁴³CV Pirro Lazi. Dokumenti

	për qartësi brenda fushës klinike dhe thellim të njohurive dhe kompetencave praktike e aplikative.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.	Plani mësimor është në harmoni me Vendimin Nr 41, datë 24.01.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, në drejtim të krediteve sipas ECTS-së, dhe respekton standartet për shpërndarjen e krediteve në çdo semestër përgjatë 1 viti akademik. Një balancë e ngjashme është respektuar edhe në shpërndarjen e krediteve në kurrikulën e programit të studimit duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Veprimtaritë formuese të ndara sipas komponentëve mësimore janë konform ligjit për arsimin e lartë ¹⁴⁴ dhe urdhrave ¹⁴⁵ duke respektuar elementët e veprimtarisë formuese në emërtim dhe në ndarjen me kredite.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Referuar të dhënave të shqyrtuara nga GVJ struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master profesional në “Psikologji Klinike”. Kemi një ndarje të tipit të komponentëve mësimorë sipas ndarjes në kategoritë A- tipi i Lëndëve Bazë që përmbajnë 10% (ECTS), Kategoria B- tipi i lëndëve Karakterizuese 40 % (ECTS), Kategoria C- tipi i lëndëve Ndërdisiplinare/Integruese 27 % (ECTS), Kategoria D- tipi i Lëndë Plotësuese 10 % (ECTS), Kategoria E- tipi i lëndëve Detyrime Përmbyllëse 13 % (ECTS). Ky program studimi respekton të gjitha kriteret përsa i përket elementëve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ndara sipas kategorive të përcaktuara me ligji (Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018) ¹⁴⁶ , duke respektuar numrin e krediteve dhe kohëzgjatjen e tij bazuar edhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ky program studimi ka një koherencë në lidhje me elementët që synon të zhvillojë tek student në mënyrë që të lehtësojë realizimin e detyrave të kërkuar në tregun e punës për profesionin e psikologut klinik”. Gjithashtu programi përfshin element mbi zhvillimin e disa shprehive profesionale që e ndihmojnë psikologun klinik të realizojë detyrën e tij të ofrimit të shërbimeve psikologjike në mënyrë profesionale. Mbështetur në disa element të rëndësishëm që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tij gjykojmë se programi i pasqyron ato si pjesë të tij. Kemi një balancë midis

¹⁴⁴Dokumenti 181. Ligji nr 802015 Për Arsimin e LArtë.

¹⁴⁵Dokumenti 189. Urdhër Nr. 251, datë 14.06.2013. Për akreditimin e disa programeve të studimit në Ba, MSH, MP.

¹⁴⁶Dokumenti 184. VKM nr 41, datë 24.01.2018. Për elementët e programeve të studimit.

	<p>mënyrës së paraqitjes së informacionit mbi ngarkesën mësimorë, ndarjen sipas semestrave, orë në auditor dhe frekuentimin, vlersimin e dijeve dhe një sër akvitetesh specifike që synojnë të mbështesin aspektin praktik të përvetësimit të dijeve të akumuluar nga studentët. Bazuar në ngjashmëritë në emërtim në planin mësimorë ky program lehtëson mobilitetin e studentëve bredna dhe jasht vendit.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përsa i përket programit të studimit PM në “Psikologji Klinike” ky program është gjithmonë në përmirësim të vazhdueshëm përmes përmirësimit të planeve mësimore çdo vit akademik dhe miratimit të tyre nga njësia bazë, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Mbetet të shohim stabilizimin tij në linjë me kërkesat e një arsimit cilësor dhe në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale që i mundëson studentit të avancojnë në fushë.</p> <p>Në linjë me profilizimin, <i>GVJ sugjeron që pedagogët që mbulojnë lëndët karakterizuese të programit, të kenë një vijimësi në të dyja apo trija ciklet e studimit brenda profilit të psikologjisë klinike.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Mënyra sesi janë ndërtuar modulet e lëndëve të japin mundësi për fitimin e shprehive profesionale. Një sër aktiviteteish të formimit teorik dhe praktik të japin hapsirat e nevojshme për të përthyer në mënyrë të duhur aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme që i lejojnë psikologut klinik të zhvillojë disa kompetenca profesionale procesin e vlersimit të problemit dhe të ndërhyrjes psikologjike, të nevojshme për një vizibilitet më të madh në tregun e punës. Megjithatë ky element duhet parë në kontekstin global, pasi personeli akademik në pjesën më të madhe referuar syllabuseve të lëndëve mësimore ^{147; 148; 149; 150; 151; 152} përdor një literaturë jo të 5 viteve të fundit. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Kjo duke iu referuar përvojës profesionale të një pjese të stafit mund të jetë mëse e mundur, por programi i lëndës dhe literatura e përdorur nga personeli akademik në drejtim të procesit të mësimdhënies shihet me dyshim.</p>

¹⁴⁷Etika Profesionale në psikologjinë klinike.


¹⁴⁸Psikologji Klinike e Avancuar.

¹⁴⁹Intervista Klinike.

¹⁵⁰Psikopatologji zhvillimi.

¹⁵¹Psikoterapitë në praktikën klinike.

¹⁵²Sistemet aktuale diagnostikuese.



	<p><i>GVJ rekomandon që njësisia bazë duhet të rishikojë në mënyrë urgjente literaturën e përdorur në dy lëndë, konkretisht: “Intervista Klinike” ku literature e vetme bazë është: - Lala, S. 2013. Psikopatologjia. Albtipografia, literaturë e cila sipas gjykimit tonë nuk lidhet drejtpërdrejt me intervistën klinike. Gjithashtu lënda mësimore “Sistemet Aktuale Diagnostike” sërisht si literature e vetme bazë ka: Lala, S. 2013. Psikopatologjia. Albtipografia.</i></p> <p><i>Për sa më sipër GVJ rekomandon, se këto problematika të evidentuara kërkojnë një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore pasi në këtë mënyrë rrezikohet që lëndë të ndryshme të dublojnë njëra-tjetrën në njohuritë që japin në auditor.</i></p> <p><i>Gjithashtu një vëmëndje më e shtuar në përfshirjen e realizimit të temave mësimore, të një literature të përditësuar dhe të përshtatshme për objektivat e lëndës mësimore, do të përmirësonte cilësinë në mësimnxënie dhe njohjen e këtij roli në një mënyrë më të konsoliduar nga ana e studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Nëse i referohemi planit mësimorë kemi një ndarje të balancuar midis veprimtarive formuese të cilat zhvillohen në auditor dhe jasht tij. Këto veprimtari kanë të ndërthurura aspektet teorike dhe praktike që të lejojnë aftësimin e studentit në përvetësimin e shprehive të nevojshme për të realizuar punën konkrete gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Praktika profesionale gjithashtu mbështet plotësisht nevojat e programit profesional për zhvillim kompetencash dhe aftësish të nevojshme për të gjetur veten lehtësisht në tregun e punës. Referuar marrëveshjeve institucionale për praktikën profesionale, studentët kanë mundësi për të përzgjedhur institucionet e praktikës në linjë me profilin e tyre profesional, që tu shërbejnë nevojave të tyre për t’u përballur e fituar njohuri dhe përvojë në fushën e psikologjisë klinike.</p>
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ky program studimi i përgjigjet më së miri nevojave aktuale të vendit por edhe nevojave të tregut kombëtarë përsa i përket profesionistëve që ofrojnë shërbime psikologjike në kontekste të ndryshme profesionale. Dinamika e jetës dhe individualizmi që bashkëshoqëron orientimin e shoqërisë drejt punës dhe angazhimeve të tjera kërkon profesionist të kualifikuar të cilët kanë kompetenca profesionale për t’u kujdesur për shëndetin mendor, për të realizuar procese vlersimi psikologjik, evidentim të problemeve të shëndetit mendor dhe ndërtimin e një plani ndërhyrje që lejon marrësit e shërbimit të përmirësojnë cilësisht</p>

	jetën e tyre personale dhe sociale. Ndërthurja e njohurive dhe shprehive profesionale që synohen të përvetësohen përmes programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” do t’i ndihmojë studentët të zotërojnë asetet e nevojshme të pritshme nga punëmarrësit e tyre			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Duke iu referuar të dhënave që kemi mbi edukimin dhe kualifikimin e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi mund të thuhet se përgjithsisht përmbushen standartet referuar titujve dhe gradave, edhe pse sugjerohet të kihen parasysh vijimësia e arsimit të tyre brenda fushës së psikologjisë klinike. Ndërthurja me pedagogjinë, si grada e tituj vështirë të justifikojë mbulimin e lëndëve karakterizuese të programit, do të kushtëzonin përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kualifikimit profesional për të ushtruar profesionin e psikologut klinik, dhe për të zhvilluar kompetencat profesionale të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Përsa i përket stafit akademik për programin e studimit në vitin akademik 2019 - 2020, sipas evidencës (<i>RVB MP. Psikologji Klinike tabela nr.6.1</i>), rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 7 pedagogë gjithsej, ku 6 PAE dhe 1 PAK, nga të cilët 5 me grada dhe tituj.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2019-2020 rezulton 86% me 14%.</p> <p>Ndërsa për vitin akademik 2020 - 2021, sipas evidencës (<i>Ngarkesa e programit sem 1,2</i>), kërkuar gjatë vizitës në institucion, rezultojnë të jenë angazhuar në mësimdhënie 6 pedagogë gjithsej, ku 5 PAE dhe 1 PAK, nga të cilët 5 me grada dhe tituj.</p> <p>Raporti PAE / PAK për vitin akademik 2020-2021 rezulton 83% me 17%.</p>
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të	Personeli akademik i angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2020-2021 na është vënë ne dispozicion dhe referuar

<p>pjeseshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>realizimit të këtij programi studimi kryesisht kanë kualifikimin e duhur dhe ka një përputhje mes angazhimit në mbulimin e moduleve mësimore të përafërta me fushën e tyre të kualifikimit. Stafit akademik i angazhuar në këtë program studimi në një rast ka një përzierje ose është i profilit të përafërta me psikologjinë por jo me profilin profesional të psikologjisë klinike (rasti i pedagogut P.L.) duke rrezikuar lehtësisht mos zotërimin e njohurive të mjaftueshme në drejtim të njohjes së thelluar të fushës në psikologjisë klinike. Referuar syllabuseve një pjesë e tyre janë hartuar dhe realizohen nga një numër vogël i stafit akademik, jo të gjithë anëtarët e stafit akademik të dërguar nga AU për këtë program studimi kanë emrin në syllabus si lektor i saj. Bazuar tek syllabuset, i gjithë plani mësimorë i këtij masteri mbulohet vetëm nga 3 pedagogë, P.L.; D.T. dhe B.L.</p> <p><i>GVJ rekomandon të tregohet kujdes në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve dhe llojit të profilit që mbulon secili pedagog.</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafit akademik me kohë të plotë është në masën 90 %. Por kemi një sër të dhënash kontradiktore lidhur me angazhimin e stafit akademik të aktivizuar në procesin mësimor në këtë program studimi. Dokumentacioni përmban CV-të e 6 prej pedagogëve të cilët janë angazhuar në mësimdhënie në MP “Psikologji Klinike”, A. Ç¹⁵³ staf akademik me kohë të pjesëshme, B.L.¹⁵⁴, D. T¹⁵⁵, I.H¹⁵⁶, P. L¹⁵⁷ si dhe S. I¹⁵⁸ janë staf akademik me kohë të plotë. Për E. I. nuk është vënë në dispozicion një CV dhe as nuk figuron tek syllabuset si lektore për ndonjërin prej lëndëve mësimore për MP “Psikologji Klinike” edhe pse është pjesë e listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”¹⁵⁹ që institucioni ka dërguar në ASCAL. Ndërkohë nëse i referohemi syllabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një mospërputhje midis Cv-ve të dërguar për stafin akademik i cili është angazhuar në këtë program studimi, listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master</p>

¹⁵³CV A. Ç. DOKUMENTI NR 62.

¹⁵⁴CV B. L. DOKUMENTI NR 63.

¹⁵⁵CV D. T. DOKUMENTI NR 64.

¹⁵⁶CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹⁵⁷CV P. L. DOKUMENTI NR 66.

¹⁵⁸CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

¹⁵⁹Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

	<p>Profesional në “Psikologji Klinike”¹⁶⁰ dhe lektorit që e realizon ngarkesën në auditor. Konkretisht tre lektorët I.H.¹⁶¹; E. I. dhe S. I.¹⁶² nuk rezultojnë të përfshira në syllabuset e lëndëve që realizohen në MP. “Psikologji Klinike”.</p> <p><u>Për sa më sipër GVJ rekomandon:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësia bazë duhet të vlerësoj me kujdes kualifikimin e kandidatit në fushën akademike dhe kërkimore. Gjatë përzgjedhjes së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë kusht i domosdoshëm për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës, përzgjedhja e stafit në mënyrë që të kenë asete për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi; - Njësia bazë të tregoj kujdes dhe t’u jap rendësinë e duhur gjatë fazës së përzgjedhjes së stafit akademik të këtij masteri respektimit të kriterëve si eksperiencia në mësimdhënie brenda këtij profili profesional dhe kontributit në kërkimin shkencorë përmes krijimitarisë personale në fushën e psikologjisë klinike, publikimit të artikujve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjes në konferenca e simpoziume shkencore;
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Marrëveshje e bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore janë faktor kyçe për profilin e psikologut klinik. Institucione si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë klinike si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹⁶³ etj, krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale por edhe në krijimin e hapsirave për të realizuar eksperiencia pune vulnetare apo pune me pagesë sipas nevojave të institucioneve që ofrojnë shërbimeve psikologjike për komunitetin. Aspekti praktik duket se preket përgjatë lëndëve të ndryshme teorike që studentët zhvillojnë në auditor dhe angazhimin në detyrat e kursit. Gjithashtu duket se në këtë aspekt një ndihmesë japin edhe aktivizimi pranë njësisë</p>

¹⁶⁰Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

¹⁶¹CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹⁶²CV S. I. DOKUMENTI NR 67.

¹⁶³Raporti vjetor 2019-2020.

	<p>kryesore të një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare ku përfshihen studentët të cilët janë të angazhuar në nisma sociale. Mbështetur në sa më sipër mund të konkludojmë se programi i studimit ka në dispozicion një strukturë që favorizon përvetësimin e njohurive praktike në drejtim të rritjes së kompetencave profesionale të studentëve që ndjekin këtë program studimi. Mbetet për t'u parë nëse edhe implementimi i këtij programi u krijon kushtet e përshtatshme që studentët të prekin terrenin e punës në formën e duhur nën moniorimin e një profesionisti i cili kryen rolin e psikologut klinik.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter disa evidenca garantojnë angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të këtij programi studimi. Gjatë vizitës në institucion komunikimi me stafin e pranishëm në takim na dha mundësi të qartësohemi plotësisht në lidhje me këtë aspekt. Vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga njësitë përkatëse përgjegjës për infrastrukturë dhe mbarëvajtjen e procesit të realizimit të orëve praktike që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.6</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i psikologjisë së Përgjithshme konform rregullave të paracaktuara nga ligjet në fuqi dhe kjo evidentohet në statutin e AU -së, mbështetur në rregulloren e këtij programi studimi master profesional. Kordinimi i punës midis njësisë kryesore, asaj bazë dhe rolit të kordinatores së programit të studimit në “Psikologji Klinike” krijojnë një infrastrukturë të përshtatshme për mbarëvajtjen e punës në këtë program studimi. Në drejtim të bashkëpunimit me partner nga tregu i punës ka një ndëveprim të drejtpërdrejt me profesionistët e terrenit në konteksin e praktikës profesionale.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Njësia bazë monitoron në vijimësi përshtyrjet e studentëve të këtij program studimi përmes rolit të kordinatorit të këtij program studimi, përmes pyetësorëve për studentët etj. Në takimet me drejtuesit e njëzisë bazë, GVJ u informua se njëzia bazë organizon takime periodike me studentët për të marrë feedback-un e tyre për mënyrën e realizimit të programit mësimor dhe aspektin e realizimit të eksperiencave të praktikës profesionale pranë institucioneve me të cilat AU ka një marrëveshje.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Institucioni ka ngritur njësinë e kordinimit dhe mbështetjes studentore dhe zyrës së karrierës dhe alumnit. Për të siguruar mbarëvajtjen e punës janë në dispozicion dhe dy rregullore¹⁶⁴, ¹⁶⁵ që drejtojnë punën e personelit të anagazhuar në këto drejtime dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit. Mbështetja e kësaj zyre nga projekte dhe institucione të ndryshme lejojnë njësinë të përshtas programin me nevojat e tregut të punës, gjithashtu përmes udhëzimit për zhvillimin e karrierës¹⁶⁶.</p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Bazuar në realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare për vitin 2019-2020, kemi praninë e një sër aktiviteteve si trajnime, workshop-e apo tryeza të rumbullakta të realizuara me institucione publike e private kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete janë realizuar në kuadër të bashkëpunimit institucional që AU ka nënshkruar për qëllime të zhvillimit të praktikës, shkëmbimit të eksperiencave dhe për realizimin e veprimtarive kërkimore shkencore. Institucione si ‘Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë’, apo qendra që ofrojnë shërbime psikologjike në fushën e psikologjisë klinike si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunktionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”¹⁶⁷ etj. Këto institucione krijojnë mundësi shumë të mirë jo vetëm në drejtim të realizimit të praktikave profesionale, në krijimin e hapësirave për të realizuar eksperiencave pune vulnetare, apo eksperiencave punë me pagesë për studentët sipas nevojave të institucioneve që ofrojnë shërbimeve psikologjike për komunitetin.</p>

¹⁶⁴V.1. Rregullore e Zyrës së koordinatorit dhe mbështetjes për studentët.

¹⁶⁵V.2. Rregullore e Zyres së karrierës dhe alumnit.

¹⁶⁶V.3. Udhëzuesi për zhvillimin e karrierës.

¹⁶⁷Raporti vjetor 2019-2020.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni ka në funksion të përmirësimit të zhvillimit dhe përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative kjo e nxitur se fundmi edhe nga kushtet e pandemisë globale. Platforma elektronike “Google Classroom” i mundëson stafit akademik dhe studentëve të shkëmbejnë materiale dhe informacione në funksion të procesit mësimor. Ky informacion u mundësua nga burime dhe dokumente të ndryshme të vëna në dispozicion.</p> <p>Institucioni ka realizuar trajnime të shumta për stafin lidhur me rritjen e kompetencave profesionale në drejtim të mësimdhënies, gjithashtu vendimi për emërimin e kordinatorit të programit të studimit, dokumenti mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, janë struktura që synojnë trajnimin dhe monitorimin në përmirësimin e metodave inovative në mësimdhënie. Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos¹⁶⁸. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesh¹⁶⁹ si tryeza e rrubullakët mbi organizimin e një ore mësimi me</p>

¹⁶⁸Trajnimi i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

¹⁶⁹Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.

	<p>lektoren e ftuar A. Sh si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom”, kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në drejtim të realizimit të monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative për personelin akademik njësia bazë ka ngritur një strukturë të quajtur Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹⁷⁰, i cili punën e tij e bazon në tre dokumenta që janë: Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë,¹⁷¹ Sigurimi i cilësisë në nivel departamenti¹⁷² dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë¹⁷³.</p> <p>Përmes tyre monitorohet puna e personelit akademik dhe ndihmës akademik në drejtim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentit në vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët¹⁷⁴, realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angzhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vlerësimet periodike të ndërmarra nga institucioni pas zbardhjes së rezultateve i vihen në dispozicion njësisë bazë dhe asaj kryesore. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim.</p> <p>- Së pari përmes raportit vjetor të vetvlerësimit të programit të studimit,¹⁷⁵ i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën</p>

¹⁷⁰VI.1.VS-ngritja e ZSBC.

¹⁷¹VI.10. Rregullore e NJSBC.

¹⁷²VI.3.VS- Sigurimi i cilësisë në nivel Departamenti.

¹⁷³VI.4. Stategjia për sigurimin e cilësisë.

¹⁷⁴III.1. Pyetësori.

¹⁷⁵VI.8. Model raporti vetvlerësimi program.

	<p>profesionale, plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra , feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti¹⁷⁶ monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Së dyti përmes fokus-grupeve të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹⁷⁷ në janar të vitit 2020 ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga AU. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni në drejtim të inkurajimit të personelit akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie përveç mundësive për publikim në revistën “Optime”, pjesmarrjes pa pagesë të stafit akademik në konferencat e përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë vendase dhe të huaja, lejon mobilitetit jashtë vendit nëpërmjet Erasmus +, përfshirjen në projekte kërkimore, aplikon në projekte kombëtare¹⁷⁸. Këto aspekte shihen si forma pozitive në drejtim të stimulimit dhe nxitjes së personelit akademik për avancim në karrierën e tyre profesionale dhe në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Mbështetur në raportin e vlersimit të brendshëm dhe në syllabuset e lëndëve mësimore, <i>gjithsesi kërkohet një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu të vet stafi akademik të angazhuar në këtë program profesional studimi, për të përditësuar dhe pasuruar sillabuset e lëndëve me literaturë të viteve të fundit.</i></p>

¹⁷⁶VI.6. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

¹⁷⁷III.2. Shkresë fokus grupe.

¹⁷⁸III,3. Raporti vjetor 2019-2020.

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga bisedat me stafin akademik, takimet me studentët dhe të tjerë aktorë, mësohet se sistemi i transmetimit të dijeve bazohet kryesisht në leksionet dhe seminarët, kjo e mbështetur në formën interaktive të zhvillimit të njohurive, në funksion të një të kuptuari më të mirë të tematikave që diskutohen në leksione. Këtyre dy formave të mësimdhënies e mësimnxënies u shtohen detyrat e kursit, provimet e ndërmjetme, dhe provimet përfundimtare. Veprimtaritë e tjera ndihmëse¹⁷⁹ si leksionet e hapura me të ftuar të profilit të këtij programi studimit, konferencat shkencore gjithashtu janë në funksion të diversifikimit të formave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me ndikim pozitiv në këtë drejtim është dhe përdorimi i sistemit të teknologjisë së informacionit nga stafi dhe studentët në funksion të rritjes së cilësisë në mësimdhënie.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të 5 viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë implementimi i këtyre kërkesave duhet monitoruar në vijimësi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave</p>	<p>Personeli akademik duket se ka kërkesa të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të lëndës/modulit me një literaturë të viteve të fundit, gjithashtu liria akademike në drejtim të</p>


¹⁷⁹III,3. Raporti vjetor 2019-2020.

<p>didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe nivelit të studentit i jep mundësi pedagogut të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktuara, përdorimi i teknologjisë si videoprojektori, diskutimi në grup, role play janë aktivitete që lehtësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Mbështetur në raportin e vlersimit të brendshëm dhe në sillabuset e lëndëve mësimore, kërkohet një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës dhe gjithashtu të vet stafi akademik të angazhuar në këtë program profesional studimi, për të përditësuar dhe pasuruar sillabuset e lëndëve me literaturë të viteve të fundit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie duke iu referuar sillabuseve, metodave të mësimdhënies sipas tematikave të ndryshme AU përgjithësisht krijon kushte për një të nxënë efektiv, kjo evidentohet edhe nga diskutimi me studentët e stafin akademik. Ndërkohë nëse i referohemi sillabuseve të dërguara ku janë shënuar krahas të dhënave të tjera edhe titullari i lëndës dhe lektori që e zhvillon atë, kemi një mospërputhje midis Cv-ve të dërguar për stafin akademik i cili është angazhuar në këtë program studimi, listës emërore të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike”¹⁸⁰ dhe lektorit që e realizon ngarkesën në auditor. Konkretisht tre lektorët I.H.¹⁸¹; E. I. dhe S. I.¹⁸² nuk rezultojnë të përfshira në sillabuset e lëndëve që realizohen në MP. “Psikologji Klinike”. Për disa lëndë literature nuk është e përditësuar, ndërsa në një rast tjetër kjo literaturë ishte e dubluar në dy lëndë të ndryshme.</p> <p><i>Njësia bazë duhet të vlerësoj me kujdes kualifikimin e kandidatit në fushën akademike dhe kërkimore. Gjatë përzgjedhjes së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi duhet të jetë kusht i domosdoshëm për mësimdhënie cilësore dhe aftësi akademike në realizimin e lëndës, përzgjedhja e stafit në mënyrë që të kenë asete për zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve të këtij programi studimi në profilin klinik.</i></p> <p><i>Sugjerohet njësia bazë të tregoj kujdes dhe t’iu jep rëndësinë e duhur gjatë fazës së përzgjedhjes së stafit akademik të këtij masteri, respektimit të kriterëve si eksperiencia në mësimdhënie brenda këtij profili profesional dhe kontributit në kërkimin</i></p>

¹⁸⁰Personeli akademik për MPPK. Dokumenti nr 1. Ngarkuar në Procedure steps.

¹⁸¹CV I. H. DOKUMENTI NR 65.

¹⁸²CV S. I. DOKUMENTI NR 67.



	<i>shkencorë përmes krijimtarisë personale në fushën e psikologjisë klinike, publikimit të artikujve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjes në konferenca e simpoziume shkencore.</i>			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Vlerësimi i këtij kriteri mbështet në kërkesën e zyrës së kurrikulës dhe cilësisë për përditësimin e literaturës, ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në këtë proces ka një përpjekje përmes rolit të kordinatorit të programit MP në “Psikologji Klinike” dhe grupit të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti si dy struktura që monitorojë kompetencat e personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Përfshirja e studentit në vlersimin periodik të formave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve dhe përdorimi i formatit të vlerësimit të pedagogëve nga studentët ¹⁸³ , realizohet në fund të çdo semestri. Studenti ka mundësi të shprehet në mënyrë anonime për pedagogët e angazhuar në mësimdhënie, por edhe për stafin ndihmës në mbështetje të mësimdhënies. Administrimi i pyetësorit i lejon atyre ruajtjen e anonimatit gjatë dhënies së vlerësimit. Gjithashtu, edhe fokus grupet janë një tjetër formë që institucioni përdor në drejtim të përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të pedagogëve.			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Nga vlersimi i mënyrës sesi janë hartuar silabuset ka larmishmëri përsa i përket formave të përdorura në mësimdhënie si role-play, studim rastesh, fokus-grupe që e vënë studentin në një pozicion aktiv gjatë orës së mësimit. Këto forma i përshtaten shumë mirë disiplinës së psikologjisë dhe ndihmojnë studentin të fitojë njohuri praktike mbi fushën e psikologjisë klinike. Gjithashtu, nga studentët për pedagogët pati në përgjithësi komente pozitive mbi formën e realizimit të leksionit por duke specifikuar se i referoheshin pedagogëve të profilit të psikologjisë klinike që u kishin dhënë mësim.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Duke u mbështetur në informacionin e marrë nga takimi me studentët dhe pedagogët, por edhe nga rregulloret dhe udhëzimet e institucionit mbi rregullat e ndërtimit të marrëdhënies pedagog –student, respektohet dinjteti dhe integriteti i çdo studentit. Proçesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet në një klimë pozitive dhe liria e mendimit respektohet duke krijuar kushte të favorshme që stimulojnë arsyetimin e thellë e të menduarit kritik të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹⁸³ III.1. Pyetësori.

			X	
--	--	--	----------	--

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni ka vënë në dispozicion infrastrukturën fizike të nevojshme për realizimin e procesit mësimor në një godinë. Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në dispozicion një sipërfaqje të mjaftueshme, në salla leksioni dhe seminari me kapacitetin e nevojshëm për numrin e studentëve të këtij program studimi. Sallat e leksionit dhe të seminarit në dispozicion të procesit mësimor janë të pajisura me videoprojektor dhe kompjuter secila. Sallat janë të pastra dhe mirëmbahen nga stafi i agjencisë së kontraktuar për këtë shërbim.
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Ambjentet në mbështetje të procesit mësimor janë brenda standardeve dhe janë funksionale, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si videoprojektor, sallat e leksionit janë të pajisura me foni dhe internet. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor një laborator informatike, bibliotekën online në Questia, Eric, Pro Quest dhe Cobbis. net. Gjithashtu një ambjent që është në shërbim të stafit dhe studentëve në lidhje me avancimin e tyre në drejtim të hulumtimit të literaturës për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin mësimor është dhe biblioteka e cila ka një kapacitet të mjaftueshëm për nevojat e studentëve të këtij programi profesional, me infrastrukturën e nevojshme si kompjuter dhe internet.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Questia, Eric dhe U-library-COBISS për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve ¹⁸⁴ . Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, bibliotekën online në "Sistemi Google Classroom" i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatës së pandemisë globale, gjë që ka bërë të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi

¹⁸⁴RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat e vulosura. Dokumenti nr 3.

	<p>komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike. Duke qenë se ky program është i karkaterit profesional, është e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që njohuritë e tyre në gjuhë të huaja nuk lejojnë në të gjitha rastet kuptimin e materialit në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë në gjuhën shqipe, e cila është dhe gjuha e realizimit të këtij programi studimi përfshin një literaturë e cila nëse i referohemi syllabuseve të lëndëve mësimore të vënë në dispozicion paraqesin një sër problemesh. Një pjesë e literaturës bazë është e një viti botimi e një dekade më parë dhe shkon ndesh me kërkesat ligjore për përditësim të literaturës mësimore me një literaturë të 5 viteve të fundit, i referohemi këtu literaturës së përdorur për lëndët si Sistemet Aktuale Diagnostike¹⁸⁵; Vlersimi dhe Testimi Psikologjik¹⁸⁶ Psikoterapitë në Praktikën Klinike¹⁸⁷ etj apo për lëndë për të cilat literatura bazë jo vetëm që nuk është e 5 viteve të fundit por tematikat e leksioneve nuk figurojnë në literaturën bazë, si në rastin e lëndës Psikopatologjitë e Zhillimit¹⁸⁸, ku tekmatikat e leksioneve 11- Crrugullimet e ushqyerjes dhe te gjumit tek fëmijët shumë të vegjël dhe 12- Traummat e fëmijërisë nuk janë pjesë të botimeve të vendosura në literaturën bazë të lëndës mësimore. Një bazë me botime në formë teksti në hard-copy mund të aksesohet në bibliotekën e AU duket e kufizuar në tituj dhe botime të psikologjisë që kryesisht përdoren si literaturë bazë në nivelin bachelor. Në një pjesë të lëndëve literatura e përkthyer në shqip dhe e përdorur për nevojat e zhvillimit të lëndëve mësimore është botimi i para 10 deri 15 viteve¹⁸⁹. Gjithashtu kemi edhe raste kur lëndët kanë dublim në literaturën bazë të përdorur si në rastin e lëndëve “Sistmet Aktuale Diagnostike” dhe “Intervista Klinike”. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj mund të thuhet se është bërë një përprjekje pozitive përmes abonimit në bibliotekën online.</p>

¹⁸⁵Sistemet Aktuale Diagnostike

¹⁸⁶Vlersimi dhe testimi psikologjik.

¹⁸⁷Psikoterapitë në praktikën Klinike.

¹⁸⁸Psikopatologjia e zhvillimit.

¹⁸⁹Psikoterapitë në praktikën klinike.



	<i>Për sa më sipër GVJ rekomandon: përditësimin e literaturës me botime të 5 viteve të fundit; si dhe kujdes nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi, në ruajtjen e një ekuilibri midis emërtimit të lëndës mësimore apo modulit dhe literaturës së përdorur për realizimin e saj.</i>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Përsa i përket botimeve në dispozicion të drejtimit kryesore të programit të studimit sipas të dhënave të bibliotekës dhe informacionit të shpërndarë nëpër dokumentet kemi një listë prej 175 tekste, nga të cilat 40 në fushën e psikologjisë. Prej të cilave pjesa më e madhe e tyre kanë një vit botimi para 2010, ndërsa ato pak tekste dhe artikuj të viteve të fundit janë punime doktorature dhe artikuj shkencorë. Një pjesë e vogël e teksteve janë në gjuhë të huaj kryesisht botime të viteve 2001-2010. Nuk kemi mjaftueshëm evidenca të vëna në dispozicion nga institucioni për të gjykuar mbi cilësinë e literaturës së detyruar që duhet të përditësohet nga pedagogu dhe që duhet ishte e pesë viteve të fundit, (siç deklarohet nga përgjegjësi i njësisë kryesore dhe bazë), kjo pasi nga shqyrtimi i literaturës në bibliotekë nuk përputhet me kërkesën e institucionit në drejtim të teksteve mësimore. Kërkesës tonë për të parë një procedurë për marrjen e teksteve të reja për këtë vit akademik nuk i vu në dispozicion ndonjë informacion apo material as nga biblioteka dhe njësisë bazë. Megjithatë pranë bibliotekës kishte një numër të konsiderueshëm teksteve online në fushën e psikologjisë, të cilat mund të përdoren nga stafi dhe studentët, por këtij aspekti i shërben edhe biblioteka online Questia dhe Eric.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Personeli akademik dhe studentët kanë në dispozicion të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies platformën elektronike të aksesimit në bibliotekën online të Questia dhe Eric, gjithashtu mund të thuhet se fondi i bibliotekës së institucionit kishte tekste në formë elektronike të fushës së psikologjisë në gjuhë të huaj që viheshin në dispozicion të stafit dhe studentëve të programit të studimit. Nuk u pa ndonjë abonim në revista të fushës së psikologjisë në bibliotekë. Biblioteka e AU-së ishte pjesë e sistemit COBISS Net (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online), ku janë të përfshira vendet e rajonit të Europës Juglindore.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studiave specifike, shfrytëzohet	Infrastruktura në mbështetje të zhvillimit të detyrave të ndryshme nga student ishte e përshtatshme dhe të lejonte akses në një sërë formash ndërveprimi, si mbulimi i ambienteve të AU-së me Wi-Fi, biblioteka e pajisur me sallë leximi dhe hapësira komode për të punuar me literaturën, kompjuter në mënyrë që studentët të

<p>në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>kenë mundësi të lexojnë literaturën on-line të vëna në dispozicion përmes shfrytëzimit të platformave online Cobiss, Questia dhe Eric.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni ofron për stafin dhe studentët bibliotekat online duke u bazuar edhe në abonimin që ka në platformat online si Questia, Eric dhe U-library-COBISS për qëllime të shfrytëzimit të literaturës për nevoja të stafit akademik dhe të studentëve¹⁹⁰. Institucioni ka në dispozicion të procesit mësimor laboratore informatike, bibliotekën online. Sistemi “Google Classroom” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatë së pandemisë globale ka bërë të mundur që studenti të azhornohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wifi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sistemi “Google Classroom” i cili ka qenë një mjet kryesor i realizimit të procesit mësimor gjatë situatë së pandemisë globale ka bërë të mundur që studenti të azhornohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive. Vërehet të ketë mundësi komunikimi nëpërmjet sistemit në komunikime të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, lejojnë studentin të jetë i informuar në kohë reale. Ambjentet janë të mbuluara me sinjal wfi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht web. Pedagogët dhe studentët shprehen se shpesh i kanë konsultuar burimet e literaturës online për nevojat e tyre akademike. Përsa i përket përdorimit të hapësirës vetjake dedikuar stafit dhe studentëve mund t’i refrohemi sistemit Google Classroom”, ku secili prej përdoruesve regjistrohet dhe në vijim akseson në sistem në çdo kohë dhe vend duke u informuar në lidhje me procesin mësimor, sezonin e provimeve, pikët e grumbulluara në lëndë e module të ndryshme etj. Ky sistem i brendshëm komunikimi shihet si tepër efektiv në drejtim të rrijës së aksesit në burimet e brendshme të informacionit si nga ana e stafit dhe e studentëve por edhe si forma kryesore e realizimit të procesit mësimor në nivel global në institucionet e arsimit të lartë si pasojë e COVID-19.</p>

¹⁹⁰RVB MP. Psikologji Klinike dhe tabelat e vulosura. Dokumenti nr 3.

<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga institucioni në lidhje me orientimin, asistimin dhe mbështetjen nga ana e personelit akademik për studentët gjatë fazës së diplomimit¹⁹¹ AU-ja ka një strukturë të mirë organizuar, e cila i krijon kushtet e nevojshme studentit në përmbylljen me sukses të kësaj faze. Kjo realizohet konkretisht nga njëësia bazë dhe kordinatori i programit të studimit, i cili paraqet studentëve listën e pedagogëve që janë në dispozicion për programin e studimit, më pas student plotëson formularin e aplikimit për temën e diplomës, departamenti bën miratimin e tyre sipas kriterëve specifike për punimin e temës duke u bazuar në udhëzuesin e saj, gjithashtu të detyrueshme për studentin takimet me udhëheqësin e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni ka ngritur disa struktura, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm në mësimdhënie. Përmes Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Komisionit të Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë, Kordinatorit të programit të studimit, Zyrës së kurrikulës.</p> <p>Puna e këtyre strukturave synon monitormin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie duke përshtatur kurrikulën e programeve të studimit me standartet shtetërore dhe ato ndërkombëtare. Strukturat përgjegjëse për monitorimin e sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standarteve të reja për rritjen e cilësisë në mësimdhënie, ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim.</p> <p>Së pari përmes raportit vjetor të vetvlersimit të programit të studimit¹⁹² i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh si vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së programit të studimit, ndyshimet apo praktikën profesionale,</p>

¹⁹¹II.8. Manuali I punimit të temës së diplomës.

¹⁹²VI.8. Model raporti vetvlersimi program.

	<p>plani i veprimit për vitin e ardhshëm, raportimi mbi veprimtaritë e ndërmarra, feedback-u i marrë nga studentët dhe stafi akademik në nivel programi, statistika të regjistrimit të studentëve dhe të kalueshmërisë së tyre, burimet mbështetëse të programit të studimit, vlersimi i jashtëm, karriera dhe alumnit, profesionet e rregulluara si dhe praktikatat e mira nga institucionet e tjera. Ky vlersim kryhet nga grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti¹⁹³ monitoron programin në vijimësi, duke u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p> <p>Së dyti përmes fokus-grupeve të organizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë¹⁹⁴ në Janar të vitit 2020 ka ndërmarrë takime me studentët e programit të studimit në lidhje me cilësinë e ofruar të shërbimeve të ofruara nga AU. Prania e këtyre elementëve konsiderohen me ndikim pozitive në drejtim të mbajtjes së lidhjeve të vazhdueshme me studentët.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Njësia kryesore dhe ajo bazë në bashkëpunim me zyrën e sigurimit të cilësisë ka ndërmarrë disa nisma që synojnë të ndihmojnë institucionin në këtë drejtim. Mjetet si raportit vjetor i vetvlersimit të programit të studimit¹⁹⁵ i cili lejon të mblidhet një informacion i detajuar mbi një sër aspektesh të rëndësishme, si dhe grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti¹⁹⁶ i cili monitoron programin në vijimësi, duhe u siguruar informacione të rëndësishme si zyrës së sigurimit të cilësisë në nivel institucional ashtu edhe njësisë kryesore dhe asaj bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat dhe njësia bazë duket se inkurajojnë format e reja dhe inovative në mësimdhënie përmes hapësirave në drejtim të organizimit të leksioneve të hapura me lektorë të ftuar vendas dhe të huaj. Institucioni duket se bën përpjekje në këtë drejtim përmes kërkesës për përditësim të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe shfrytëzimit të bibliotekës online.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të</p>	<p>Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të</p>

¹⁹³VI.6. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

¹⁹⁴III.2. Shkresë fokus grupe.

¹⁹⁵VI.8. Model raporti vetvlersimi program.

¹⁹⁶VI.6. Grupi i cilësisë në nivel departamenti.

<p>ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos¹⁹⁷. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesh¹⁹⁸ si tryeza e rrubullakët mbi organizimin e një ore mësimi me lektoren e ftuar A. Sh si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom”, kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik, gjithashtu synon të mbështetet ky aspekt nga institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>AU duke u mbështetur në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie ka realizuar një sër aktivitetesh që kishin në fokus trajnimin e stafit. Ndër to mund të evidentojmë disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas, si trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos¹⁹⁹. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesh²⁰⁰ si tryeza e rrubullakët mbi organizimin e një ore mësimi me lektoren e ftuar A. Sh si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom”, kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli i angazhuar në këtë program studimi kërkon të përmirësohet vazhdimisht, kjo lidhur me kualifikimin dhe fushën e ekspertizës së zotëruar dhe përputhjes me lëndët apo modulet që mbulojnë, duke e vënë theksin jo vetëm te vijimësia në tre cikle studimi brenda fushës, por edhe në kualifikime të tjera profesionale që përkojnë me lëndën që mbulojnë.</p> <p><i>Referuar evidencave të vëna në dispozicion lidhur me syllabuset e lëndëve dhe cv e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, GJV rekomandon që ky kriter nevojitet të shihet në vijimësi, kjo pasi një pjesë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi rezulton të përdor një literaturë të vjetëruar, dublim të të njëjtës literaturë bazë për dy lëndë të ndryshme, herë -herë të paqartë në lidhje me burimet e referencës që u zhqyrtuan nga</i></p>

¹⁹⁷Trajnimit i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

¹⁹⁸Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.

¹⁹⁹Trajnimit i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

²⁰⁰Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.



	<i>GVJ si pjesë e syllabusit të lëndës që mbulonin dhe pa një linjë të pastër të kualifikimit në fushën e psikologjisë klinike.</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Në lidhje me këtë kriter nuk kemi evidence të qarta përsa i përket testimit dhe analizës nga ana e stafit mbi metodat e reja në mësimdhënie. Por vërtetohet se ka procedura që ndiqen nga institucioni mbi monitorimin e procesit të mësimdhënies përmes formatit të vlerësimit të pedagogut nga studenti, dhe formulari i vetvlerësimit të performancës, procedura që synojnë nxitjen e kërkesave personale në drejtim të rritjes profesionale të stafit të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p><i>Sugjerohet nga GVJ, një punë më e mirë nga njësia bazë në drejtim të monitorimit me kujdes të syllabuseve të lëndëve që miraton pasi ky aspekt duke iu referuar syllabuseve të lëndëve paraqeset mangësi të dukshme të cilat duhet të adresohen shpejt dhe drejt në mënyrë që të mos çënojnë programin e studimit dhe cilësinë e shërbimit që meritojnë të marrin studentët e masterit profesional në “Psikologji Klinike”.</i></p>			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	<p>Bazuar në nevojën e rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe të trajnimit të stafit akademik janë realizuar disa aktivitete me profesorë të ftuar të huaj dhe vendas. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos²⁰¹. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitete²⁰² si tryeza e rumbullakët mbi organizimin e një ore mësimi me lektoren e ftuar A. Sh., si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom” nga lektore G.R. Kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik synon promovimin dhe mbështetjen e stafit për të avancuar në karrierë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


²⁰¹Trajnimi i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

²⁰²Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore të programit të studimit, sistemin e vlersimit të studentit, formatin e tezës së provimit përfundimtar, mbi punimin e diplomës. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët në kohë reale edhe duke shfrytëzuar sistemin google classroom apo platformat elektronike që përdoren nga studentët e këtij program studimi. Një sërë procedurash që lidhen me testimin dhe vlerësimin e njohurive bëhen publike dhe njihen nga studentët edhe përmes sekretarisë mësimore dhe vetë pedagogut të lëndës në fillim të çdo semestri. Kjo procedurë respektohet nga stafi akademik dhe studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në silabuset e lëndëve/moduleve, në orët e para, si dhe ky informacion i jepet studentit në departamentin e psikologjisë.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në hartimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit MP në “Psikologji Klinike” në fillim të çdo semestri nga titullari i lëndës bëhet njohja me të gjitha aspektet që përfshijnë studentët. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlersimin e performancës akademike të studentit.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Studentit i jepen hapësirat e nevojshme për të demonstruar përvetësimin e njohurive përmes vlersimit nga detyrat e kursit, mendimet dhe reflektimet personale të shpalosura në auditor, formës së hartimit të testit të ndërmjetëm dhe final me diversitet pyetjesh dhe formash të nxitjes së të nxënit. Duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë:</p>



	<p>provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma, për programin e studimit. Nuk kemi evidenca për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Bazuar në procedurën e përcaktuar në rregulloren e programit të studimit, vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë: nxitjen e studentit që të mësojë gjatë gjithë vitit, realizimi i një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim dhe në funksion të vlerësimit të ecurisë së kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. Aplikimi i kësaj praktike për testim dhe vlerësim shihet si pozitive në drejtim të një objektiviteti në vlerësimin e performancës akademike të studentit. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim ose me gojë. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit. Nuk kemi evidencë për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit përmes sekretimit të provimeve dhe në kushtet e Pandemisë pjesa më e madhe e tyre realizohen në platformat elektronike. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm mësohet të jenë: provimet, detyrat e kursit/detyrat praktike dhe niveli i aktivizimit në seminare. Provimi synon vlerësimin e njohurive dhe të aftësive argumentuese të studentëve dhe janë me shkrim. Llojet e provimeve që zhvillohen për kontrollin e dijeve</p>

	<p>janë: Provimi i ndërmjetëm, Provimi përfundimtar, Riprovimi, Përmirësimi, Diploma për programin e studimit MP në “Psikologji Klinike”. Nuk kemi evidence për realizimin e testimit përmes sistemit elektronik, por ekziston një strukturë e mirëorganizuar përmes sistemit google classroom për paraqitjen e vlerësimit të studentëve në të gjitha aspektet e përmëndura më sipër.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Njësia bazë ka një procedurë të mirëorganizuar në drejtim të hapave e afateve kohore që ndjek në drejtim të miratimit, dhe kohës së përgatitjes së tezës së provimit nga pedagogu i lëndës. Disa prej këtyre aspekteve kanë të bëjnë me; dorëzimin të paktën një ditë përpara zhvillimit të provimit për t'u miratuar nga Përgjegjësi i njësisë bazë, kur numri i studentëve në sallën e provimit e tejkalon 50% të kapacitetit të saj, pedagogu duhet të përdorë dy teza të ndryshme. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për zhvillimin e provimit, por ai shoqërohet nga një anëtar i stafit akademik. Praktikant profesional, dhe mbrojtja e diplomave realizohen me komision prej dy ose më shumë anëtarësh.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim nga ana e personelit ndihmës akademik të departamentit që bën sekretimin e tezave. Me përjashtim të pedagogut të lëndës, të monitoruesve të ngarkuar nga drejtuesi i departamentit, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë. Tezat janë të sekretuara dhe provimi realizohet duke ruajtur anonimatin e çdo studenti. Çekretimi i tezave të korrigjuara të provimit dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, e cila bën çekretimin e tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. Nuk kemi evidence për përdorimin e mjeteve të tjera të survejimit të provimit me qëllim që të shmangen abuzimet.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në lidhje me komentet apo feedback-un mbi rezultatet e testimit nuk kemi evidence për të gjykuar plotësisht mbi këtë aspekt, por ka procedurë të mirëorganizuar për mënyrën, sesi hartohet teza dhe realizimi i vlerësimit në mënyrë të copëzuar që t'u japë mundësi studentëve që iu përshtaten stileve të ndryshme të të nxënës. Pedagogu i lëndës pas provimit dorëzon në departament tezen origjinale dhe çelësin e zgjidhjes së tezës, të cilat mund t'i vihen në dispozicion studentit, nëse dëshiron të qartësohet.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Respektimi i procedurave dhe realizimi me korrektësi nga stafi akademik synojnë që përmes rregullave që lidhen me kushtet si mospërdorimi i së njëjtës teze provimi për grupe që e zhvillojnë provimin në orare të ndryshme, dhe as përsëritja e së njëjtës teze brenda të njëjtë vit akademik (përfshirë sezonin e riprovimit) japin</p>

	mundësi të mirat për të shmatur plagjiaturën dhe kopjimin në provime dhe detyra. Drejtuesi i Departamentit garanton zbatimin e këtij rregulli.			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Institucioni disponon një procedurë të mirëfilltë përsa i përket gjithë procesit që lidhet me procedurat e provimit, vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit nga ana e studentit. Procedura që zbatohet nga institucioni përfshin rregullat sipas përcaktimeve përkatëse sesi bëhet kontrolli i vazhdueshëm i dijeve, hyrjen në provim dhe gjithçka tjetër që i përket këtij procesi të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabusin e lëndës.			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni respekton procedurat e njohjen me vlerësimin, kushtet dhe hapat për rishikimin e vlerësimit. Këto procedura janë konform legjislacionit në fuqi dhe rregullores së programit të studimit.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Duke u bazuar te rregullorja e AU-së, por edhe te rregullorja e programit dhe dokumenti mbi sistemin e vlerësimit të studentëve ekziston një procedurë, e cila i jep mundësi studentëve të ndjekin këtë proces në mënyrë korrekte. Rivlerësimi i testimit bëhet nga një komision i posaçëm konform rregullave ligjore dhe në mbështetje të të drejtave të studentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit i jep mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të gjerë të profileve interdisiplinare në kontekstin e fushës së psikologjisë klinike, por kjo larmishmëri mund të shihet edhe si jo e plotë nëse lëndët mësimore bazohen në një literaturë të përsëritur ²⁰³ të atyre njohurive që studentët i kanë marrë në ciklin e parë të studimeve, apo kur literatura bazë dublohet në

²⁰³Psikopatologji zhvillimi.

	<p>lëndë të ndryshme mësimore,^{204,205} apo nëse literatura nuk përditësohet me një literaturë të pesë viteve të fundit. Në drejtim të thellimit të njohurive për aspektet më të imta që lidhen me fushën e psikologut klinik dhe në një aftësim për të zhvilluar kompetenca profesionale tek studentët, lidhur me profilin e psikologut klinik kërkohet që stafi të realizojë një përditësim të njohurive akademik mbi zhvillimet e fundit në këtë fushë, të cilat gjithashtu edhe duhet të shpalosen në syllabusin e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Institucioni dhe ky program studimi synojnë krijimin e kushteve që studentët të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit në aspektin praktik përmes trajnimit të studentit për të përdorur sistemin “Google classroom” dhe sitemin online të shfrytëzimit të literaturës në bibliotekat online. Në drejtim të komunikimit dhe ndërveprimit kemi një sër aktivitetesh që ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim si angazhimi i stafit bashkë me studentët në qendrën e këshillimit psikologjik dhe aktivitetet ekstra kurrikulare ku janë përfshirë studentët si veprimtari bamirësie, konferenca dhe leksione të hapura që u japin mundësi ndërveprimit.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në këtë drejtim kemi nismën e njësisë bazë, e cila realizon në mënyrë periodike analizën e punës, ku kërkon në fund të semestrit nga pedagogu i çdo lënde apo moduli një analizë të punës në lidhje me objektivat e arritura të lëndës si dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen.</p> <p>Kontrolli i Brendshëm i Cilësisë, përmes fokus-grupeve me student, ka organizuar montorimin e kënaqësisë nga shërbimet e ofruara nga AU për studentët për nivelet BA, MP, MSh. Prezenca e këtyre praktikave në institucion shihet si element pozitiv në drejtim të përpjekjeve për të ofruar lëndë e module që synojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësitë e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në lidhje me aplikimin e këtij standarti kemi evidenca për të nxjerr konkluzione dhe diskutimin e orientuar të studentëve para provimeve nga secili prej personelt akademik që është angazhuar në këtë program studimi. Pedagogu i çdo lënde në fund të semestrit para provimit përfundimtarë realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara gjatë lëndës/modulit dhe orienton studentin për provimin përfundimtar.</p>

²⁰⁴Intervista Klinike.

²⁰⁵Sistemet Aktuale diagnostike.

<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në këtë drejtim institucioni ka praktika të mira përsa i përket hapësirave që ka stafi akademik për të përfituar nga evente të ndryshme, të cilat realizohen përgjatë vitit akademik, si konferenca, simpoziume, leksione të hapura me të ftuar dhe personalitete të larta të vendit dhe të huaj, veprimtari promovuese. Personeli akademik dhe studentët janë të angazhuar në pjesëmarrjen në këto veprimtari. Ndër to mund të evidentojmë trajnimin e Prof. G. A. me tematikë mbi “Teknologjinë në mësimdhënie, me mbështetjen e programit ERASMUS+ 2017 dhe Universitetin e Salernos²⁰⁶. Po ashtu vlen të theksohen si të përshtatshme edhe një sër aktivitetesh²⁰⁷ si tryeza e rrumbullakët mbi organizimin e një ore mësimi me lektoren e ftuar A. Sh si dhe leksioni i hapur mbi përdorimin e platformës elektronike “Google Classroom” nga lektore G.R., kjo e fundit i përgjigjet më së miri edhe nevojave aktuale të institucioneve të arsimit të lartë si përgjigje ndaj situatës së pandemisë globale. Përmes krijimit të mundësisë për publikim në revistën “Optime” dhe pjesëmarrjes në konferencat që AU organizon pa pagesë për stafin e tij akademik krijohen mundësi të tjera në këtë drejtim.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Përsa i përket mundësisë për zhvillimin e mësimdhënies mbi bazë kompetencash ka evidenca që na ndihmojnë të gjykojmë mbi këtë aspekt. Disa module të lëndëve karakterizuese jo vetëm kërkojnë njohuri të thelluara teorike të marra përmes kualifikimit akademik, por gjithashtu njohuri dhe kompetenca praktike që janë zhvilluar përmes përvojës praktike të fituar drejtpërdrejtë në fushë të cilat përmes diskutimit të studimeve të rasteve të sjella nga vetë pedagogu zhvillojnë kompetencat profesionale të studentëve.</p> <p>Gjithsesi, vlerësohet që ka problematika që ndikojnë negativisht në këtë aspekt si literature e vjetëruar, të cilat nuk janë përditësuar me literaturë të 5 viteve të fundit, dhe dublimi i literaturës bazë në lëndë të ndryshme mësimore. Kjo gjë të kapërcehet nëse stafi akademik angazhohet në një proces përmirësimi të literaturës së përdorur për nevojat e lëndës mësimore dhe në përputhje me emërtimin e saj.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Ky kriter bazuar në mënyrën e ndërtimit të silabuseve të lëndëve/moduleve por edhe bazuar në takimet e realizuara me stafin akademik dhe studentët, duket se përmbushet plotësisht. Pasi mësimdhënia bazohet në diskutimet e ndryshme, studimet e rasteve, nxitjen e mendimin kritik mbi çështjet që trajtohen duke e</p>

²⁰⁶Trajnimi i personelit me prof. te huaj. Dokumentin nr 36.

²⁰⁷Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.

<p>problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>vendosur studentit në një pozicion aktiv në drejtim të përvetësimit të dijeve dhe të nxëniet në tërësi.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Ky element duhet parë në vijimësi, pasi personeli akademik në pjesën më të madhe referuar syllabuseve të lëndëve mësimore,²⁰⁸; ²⁰⁹; ²¹⁰; ²¹¹; ²¹²; ²¹³ përdor një literaturë jo të 5 viteve të fundit. Mënyra sesi do implemetojë në planin mësimorë të lëndës idetë inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore në mbështetje të nevojave të studentit në lidhje me avancimin në njohuri mbetet një sfidë. Kjo duke iu referuar përvojës profesionale të një pjese të stafit mund të jetë mëse e mundur, por program i lëndës dhe literatura e përdorur nga personeli akademik në drejtim të procesit të mësimdhënies shihet me dyshim.</p> <p>Gjithashtu një tjetër evidencë që duhet të adresohet në mënyrë urgjente nga njësia bazë është literature e përdorur në dy lëndë, konkretisht “Intervista Klinike” ku literature e vetme bazë është: - Lala, S. 2013. Psikopatologjia. Albtipografia, literaturë e cila sipas gjykimit tonë nuk lidhet drejtpërdrejt me intervistën klinike. Gjithashtu lënda mësimore “Sistemet Aktuale Diagnostike” sërish si literature e vetme bazë është: Lala, S. 2013. Psikopatologjia. Albtipografia.</p> <p><i>Bazuar në këto problematika të evidentuara GJVJ rekomandon një angazhim më të madh nga strukturat përgjegjëse të njësisë bazë, në monitorimin dhe miratimin e syllabuse të lëndëve mësimore pasi në këtë mënyrë rrezikohet që lëndë të ndryshme të dublojnë njëra-tjetrën në njohuritë që japin në auditor.</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Bazuar në përfshirjen në projekte apo përfshirjen në botime të artikujve dhe punëve shkencore në bashkëpunim me pedagogët, apo bashkëpunimi për konferenca kemi disa evidenca lidhur me organizimin e konferencës studentore, e cila është e përvitshme. Në këtë konferencë, studentët duke bashkëpunuar me pedagogët e tyre paraqesin punimet e tyre kërkimore. që të na tregojë përfshirjen e studentëve të këtij programi studimi. Për vitin 2019-2020 bazuar në raportin e veprimtarive ekstra kurrikulare²¹⁴ kemi raste të studentëve të departamentit të psikologjisë së përgjithshme të përfshirë në një sër aktivitetesh ekstrakurrikulare dhe bamirësie.</p>

²⁰⁸Etika Profesionale në psikologjinë klinike.

²⁰⁹Psikologji Klinike e Avancuar.

²¹⁰Intervista Klinike.

²¹¹Psikopatologji zhvillimi.

²¹²Psikoterapitë në praktikën klinike.

²¹³Sistemet aktuale diagnostikuese.

²¹⁴Raporti vjetor 2019-2020.

<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Përsa i përket bashkëpunimit në drejtim të mësimdhënies me institucionet e tjera kemi nisma me një sër institucionesh brenda dhe jasht vendit të organizuara nga AU si konferenca, workshop-e, trajnime të stafit lidhur me rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Gjithashtu një veprimtari e vlefshme është ajo me Urdhrin e Psikologut, mbi kriteret dhe kushtet e liçensimit të psikologëve, dhe mobiliteti i stafit dhe studentëve të këtij programi shihet si pozitiv, por është herët për të vlerësuar vijimësinë e tij.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Në funksion të praktikës profesionale janë nënshkruar një sër marrëveshjes intucionale si ato me “Kryqin e Kuq Shqiptar”, Qendrën Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendrën Multifunksionale të Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan”²¹⁵ etj. Këto marrëveshja janë nënshkruar pa afat dhe me fokus bashkëpunimi në një sër fushash. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione të specializuara në fushën e psikologjisë klinike u japin mundësi studentëve të zhvillojnë praktikën profesionale pranë qendrave që kanë shërbim psikologjik dhe psikologë klinikë në organikën e tyre. Në këtë mënyrë krijohen kushtet që studentët të përfitojë nga përvoja dhe profesionalizmi i profesionistëve të terrenit. Vlen të theksohet se qendrat e sipërpërmendura janë në përputhje me profilin e masterit profesional në “Psikologji Klinike” duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij program studimi.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka krijuar edhe mjedis profesionale brenda tij si Zyra e këshillimit psikologjik dhe ajo e këshillimit të karrierës</p>

²¹⁵Raporti vjetor 2019-2020.

	të përshtatshme për mbështetjen e veprimtarive në funksion të praktikës klinike dhe praktikës profesionale.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Në funksion të praktikës profesionale janë nënshkruar një sër marrëveshesh me intitucione si “Kryqi i Kuq Shqiptar”, Qendra Sociale “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Multifunkionale e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore “Family”, Klinika e Shërbimeve Psikologjike “Laboviti”, Klinika e Psikologjisë Elbasan, Instituti i Psikologjisë Individuale “Alfred Adler”, Qendra “Jonathan” ²¹⁶ etj, pa afat. Këto marrëveshje bashkëpunimi me institucione të specializuara në fushën e psikologjisë klinike u japin mundësi studentëve të zhvillojnë praktikën profesionale pranë qendrave që kanë shërbim psikologjik dhe psikologë klinikë në organikën e tyre. Në këtë mënyrë krijohen kushtet që studentët të përfitojë nga përvoja dhe profesionalizmi i profesionistëve të terrenit. Vlen të theksohet se qendrat e sipërpërmendura janë në përputhje me profilin e masterit profesional në “Psikologji Klinike” duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale të studentëve të këtij program studimi.			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikat profesionale si pjesë e kurrikulës shoqërohen me një numër të caktuar kreditesh që fitohen nga përmbushja me sukses e të gjitha parakushteve të lëndës. Bazuar në elementët që shoqërojnë këtë lëndë titullari i saj aplikon edhe një sër elementësh të tjera që rrisin suksesin e realizimit të saj. Kjo përmes rolit të supervizorit në terrenin klinik i cili bën një vlersim të performancës së studentit në përfundim të praktikës në institucionin pritës. Studenti përgjatë stazhit është nën monitorimin e psikologut klinik të licensuar nga Urdhi i Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe që mbulon këtë rol në institucionin pritës për praktikën. Ky format vlersimi është një ndër dokumentet bazë mbi të cilin bëhet edhe vlersimi me notë nga titullari i lëndës. Gjithashtu kjo përvojë praktike i njihet studentit si eksperiencë punë në fushën e tij profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9

²¹⁶Raporti vjetor 2019-2020.

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Bazuar në rregulloren mësimore të programit²¹⁷ të studimit MP në “Psikologji Klinike” dhe në manualin e punimit të temës së diplomës²¹⁸, institucioni ka hartuar procedurë të posaçme për studentët, të cilët mbrojnë diplomën. Kriteret për mbrojtje diplome me temë dhe lista e pedagogëve udhëheqës për këtë program studimi bëhen të ditura përmes kordinatorit të programit. Njësia bazë ka një format të posaçëm për realizimin e recensës²¹⁹ dhe oponencës²²⁰ për çdo student.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Përsa i përket procedurës që ndjekin studentët e këtij programi në përfundim të këtij cikli studimit për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës me temë, njësia bazë dhe kordinatori i programit kanë një rol kyç. Bazuar në formatin e njësisë bazë, kemi një manual udhëzues²²¹ për mënyrën e strukturimit të temës dhe të gjitha çështjet teknike. Mbrojtja e diplomës me temë ka një procedurë që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës, si dhe monitorimin e punës përmes seancave individuale me udhëheqësin, që janë të detyrueshme nga studenti për t’u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Monitorimin e zbatimit të këtyre procedurave e realizon njësia bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Mbështetur në procedurat e njësisë bazë mbi administrimin e mbrojtjes së diplomës për programin e studimit MP në “Psikologji Klinike” komisioni i ngritur për këtë qëllim ndjek parimin e përmbushjes së kriterëve shkencorë lidhur me praninë e të gjithë elementëve shkencorë dhe profesional që përmban qasja e përdorur nga studenti konform shkrimit të një punimi kërkimor shkencorë. Duke qenë një master profesional ka mungesa të thellimuar të njohurive në planin shkencorë që përvetësohen përmes realizimit të lëndëve të metodave të kërkimit shkencorë. Gjykojmë se do ishte e vështirë realizimi i temës së diplomës konform rregullave të kërkimit shkencorë.</p> <p><i>GVJ sugjeron që njësia bazë të hartojë një udhëzues diplome që orientohet më tepër drejt studimit të rastit apo dosjes</i></p>

²¹⁷II.4. Rregullorja e programit të studimit MASTER Profesional.

²¹⁸II.8. Manuali I punimit te temës së diplomës.

²¹⁹III.9. Formulari I pedagogut udhëheqës.

²²⁰III.10. Formulari I pedagogut oponent.

²²¹II.8. Manuali I punimit te temës së diplomës.

	<i>profesionale. Kjo me qëllim që të lehtësojë edhe shpалosjen e njohurive teoriko-praktike që kanë përvetësuar përgjatë vitit akademik por edhe për t'u testuar në drejtimin e profilit të tyre profesional dhe kompetencave që masteri në fjalë jep mundësinë të përvetësojnë.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Stafi akademik i këtij programi studimi ka rol mbështetës dhe orientues në drejtim të përgatitjes së studentëve për t'u njohur me opsionet e procedurat që duhet të ndjekin gjatë realizimit të temës së diplomës, rregullat dhe përgjegjësitë e palëve, problematikat me plagjiaturën etj, duke qenë të hapur të ndihmojnë studentët nëse kanë pyetje apo paqartësi në lidhje me metodologjinë e përdorur. Përsa i përket përgatitjes së temës së diplomës kemi një procedurë formale të përcaktuar nga rregullorja e programit të studimit dhe monitoruar nga njësia bazë, e cila detyron studentin dhe pedagogun në realizimin e takimeve udhëheqëse përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së punimit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në drejtim të krijimit të mundësive për realizimin e punëve kërkimore nga ana e studentëve jashtë institucionit, AU ka nënshkruar një sër marrëveshjesh bashkëpunimi ²²² , të cilat janë tepër të vlefshme për këtë profil profesional. Megjithatë kemi pak evidenca që na lejojnë të arrijmë në përfundime në lidhje me asistimin e ofruar nga institucioni në terma faktik. Përsa i përket asistimit brenda kemi një sërë lehtësirash që e ndihmojnë studentin, si takimeve me udhëheqësin, konsultat me pedagogët, aksesin në bibliotekat online, mjedisi i brendëshëm i mbuluar me wi-fi, biblioteka dhe salla e leximit.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës përmes takimeve udhëheqëse i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. Një tjetër element që dokumenton këtë proces dhe të orienton dhe komisionin e mbrojtjes së diplomimit është edhe relacioni që udhëheqësi ²²³ dorëzon për temën e studentit që ka monitoruar. Një sistem që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe lufton plagjiaturën do e lehtësonte mjaft këtë proces.

²²²Evidencë R2.

²²³III.9. Formulari I pedagogut udhëheqës.

<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit²²⁴ dhe rregulloren e brendshme të programit të studimit²²⁵ vlerësimi i studentëve në përfundim të punimit të diplomës vlerësohet me notë nga komisioni i vlerësimit. Ky komision përbëhet nga personel me grada dhe tituj akademik, i përbërë nga 3 deri në 5 anëtarë. Komision në mbrojtjen e diplomës ka në dispozicion për çdo student një relacion nga udhëheqësi dhe oponenti i temës.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën²²⁶, listë notash²²⁷ dhe suplementin e diplomës²²⁸ në programin e studimit “Master Profesional” në “Psikologji Klinike”. Kjo formë e paraqitjes së diplomës është konform dokumentacionin që shoqëron këtë rrugëtim profesional të studentëve. Ky kualifikim emërtohet në të njëjtën formë si në modelin e diplomës dhe në listën e notave e suplementin e diplomës dhe janë të unifikuara dhe me emërtimin, me të cilin programi ka marrë vendimin për riorganizim të tij nga MASR. Ky program studimi synon ndërthurjen midis kompetencave profesionale të studentit dhe pajisjen me diplomë profesionale referuar nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve²²⁹.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve një kopje zyrtare të silabuseve të këtij programi studimin në varësi të kërkesës së bërë dhe për interesa të vetë studentit. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore harton dhe pajis studentin me Suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Institucioni për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe paisjen e studentit me informacionin e nevojshëm ndjek rregullat që i dikton legjislacioni. Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Nga takimi me aktorët përkatës mësohet se institucioni disponon një database të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë</p>

²²⁴1.2. Rregullore e përgjithshme e AU.

²²⁵II.4. Rregullore e programit të studimit Master Profesional.

²²⁶III.1.1.a. Diplomë Master profesional në Psikologji Klinike.

²²⁷III, 11.b. Lista e notave.

²²⁸III.11.c. Suplementi i diplomës.

²²⁹Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. <http://ëëë.akafo.gov.al/ëp-content/uploads/2014/09/NIVELET-E-KORNIZ%C3%8BS-SHQIPTARE-T%C3%8B-KUALIFIKIMEVE.pdf> (Aksesuar më datë 07-01-2021).

	për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahëse	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përkrahëse	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe atij të marrë gjatë vizitës pranë këtij Institucioni rezulton se struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit master profesional “Psikologji klinike” është Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme. Këto instanca mbajnë të dhëna në lidhje me stafin akademik dhe administrativ përfshirë dhe ngarkesat për çdo semestër të vitit akademik. Ngarkesa mësimore që mbulohet nga stafi akademik me kohë të plotë është në masën 90 %, por kemi një sër të dhënash kontradiktore lidhur me stafin akademik të angazhuar në procesin mësimorë në këtë program studimi.
Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Referuar informacionit në dosjen e vetëvlerësimit, faqes zyrtare web (http://albanianuniversity.edu.al/) të institucionit por dhe informacionit të siguruar nga vizita në universitet rezulton se procesi i rekrutimit përfshirë kriteret e përgjithshme dhe specifike janë transparente për aplikantët si dhe duke informuar ata mbi mundësitë e punësimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik. Procedura e rekrutimit dhe njoftimet për vende të lira pune publikohen periodikisht në faqen zyrtare të Universitetit dhe

	janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Statutin ²³⁰ dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit.			
Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Referuar informacionit në dosjen e vetëvlerësimit dhe informacionit të siguruar nga vizita në universitet, konstatohet se identifikimi i vendeve të lira dhe kërkesat për staf akademik bëhet sipas procedurës çdo fillim semestri dhe në fund të vitit akademik. Departamenti përgjegjës që është Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme identifikon këto nevoja dhe i përcjell tek Dekani i Fakultetit i cili ndjek më tej procedurën. Vendet vakante dhe kriteret e posaçme dhe specifike publikohen në faqen zyrtare të institucionit.			
Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstatoi se institucioni “Albanian University” procedura e rekrutimit dhe vlerësimit të kandidatëve është transparente dhe konkurrese. Siç përshkruhet dhe në kontratën e punës kandidatët e zgjedhur pasi kalojnë periudhën e proves (deri në 3 muaj) vendoset nëse janë të kualifikuar për të vazhuar më tej marrëdhënien kontraktuale me institucionin apo jo.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ konstatoi se institucioni “Albanian University” zhvillon aktivitetet mësimore në ambjent i cili është i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Bazuar në informacionet e marra nga takimet me stafin si dhe nga informacioni i siguruar nga RVB rezulton se platforma e-learning si dhe mësimi fizikisht në auditor zhvillohet në përputhje me rregulloret e brendshme si dhe ligjet në fuqi. Këto

²³⁰Statuti AU I riorganizuar sipas Ligjit Nr.80-15. Dokumenti nr 13. (neni 36)

	sigurojnë krijimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryrjen e detyrave.			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Programi i masterit profesional në “Psikologji klinike” është nën administrimin e Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Gjatë takimit me stafin e institucionit konstatohet që Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është njësia që organizon trajnimet periodike në përputhje me kornizën dhe statutin. ²³¹ Po ashtu në drejtim të trajnimeve profesionale që duhet të ofrohet duhet të ketë një rritje të programeve Erasmus +; të dhënat tregojnë se ka pasur trajnime të tilla të ofruara për stafin e AU, student dhe alumnit (ish student) kanë marrë pjesë në aktivitetin dy ditorë GRADUA, të financuar nga Erasmus + por ato duhet të jenë më të shumta.			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	GVJ konstatoi se institucioni disponon një Plan të Zhvillimit Strategjik të Universitetit ²³² në të cilin janë të specifikuar si pjesë përbërëse e tij kualifikimi i mëtejshëm profesional i personelit akademik. Më tej është zbatim i tyre i cili mundësohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila organizon trajnimet për rritjen dhe zhvillimin e personelit. Mënyra e zhvillimit të tyre është si me pjesëmarrje fizike ashtu dhe me anë të platformës e-learning. Ekipi ofrues i trajnimeve përbëhet si nga trajnues vendas ashtu dhe trajnues të huaj.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm pune dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin e angazhuar. Bazuar në informacionin e dosjes së vlerësimit dhe takimeve apo informacioneve të marra gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se lektorët e këtij program studimi mbajnë titullin Profesor dhe Profesor i Asociuar si dhe gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

²³¹Trajnime 2019-2020. Dokumenti nr 35.

²³² I.1 Plani strategjik institucional 2017 – 2022, dokumenti 10

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit “Psikologji Klinike” i zhvillon aktivitetet mësimore në godinën e Albanian University të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Kjo infrastrukturë përfshin klasat me hapsira të mjaftueshme, sallë konferencash të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se në funksion të programit të studimit janë salla leksionesh dhe klasa përkatëse të cilat në varësi dhe të aktivitetit përshtaten pasi ato disponojnë tyreza pune për përshtatjen e ambjentit duke nxitur ndërveprimin.</p> <p>Sallat e leksioneve dhe seminareve janë në sipërfaqe optimale dhe bashkëkohore. Ato janë të pajisura me mjetet e nevojshme audio vizive si: kompjuter, videoprojektor si dhe sistem fonie për të lehtësuar procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Natyrë specifike e këtij programi studimi nuk aplikon dhe kërkon orë specifike që përmbajnë përdorimin e aparaturave dhe mjeteve të nevojshme. Moduli i metodave të kërkimit shkencor mund të kërkojë përdorimin e laboratorëve të teknologjisë së informacionit të cilin e kanë në dispozicion.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i teknologjisë së informacionit ka një kapacitet me 30 vende pune aktive. Studentët mund të aksesojnë lirisht këtë laborator për realizimin e detyrave të kursit apo detyrime të tjera të lëndëve. Ky laborator ndodhet në godinën ku zhvillohet programi dhe studentët në rast nevoje kanë asistencën teknike të një personi përgjegjës në këtë laborator.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave</p>	<p>Praktikat mësimore profesionale realizohen në institucionet të ndryshme private ose publike me të cilët universiteti ka marrëveshje por dhe që kanë të specifikuar në organikën e tyre funksionin e psikologut klinik.</p>

profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni dhe vizitës në institucion, GVJ konstatoi se Albanian University vë në dispozicion të gjithë studentëve të regjistruar pranë këtij universiteti një sallë biblioteke.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se Albanian University disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; e cila mund të shfrytëzohet njëlloj nga të gjithë studentët e universitetit. Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni janë rreth 175 tituj të disponueshëm për tu aksesuar jo vetëm nga studentët por dhe për pedagogët specifikisht në fushën e psikologjisë; 40 tituj janë në ndihmë të programit të studimit “Psikologji klinike”. <i>GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës me libra të tjerë fizik.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët si fizikisht ashtu dhe në biblioteka on-line. Studentët e këtij program studimi kanë në dispozicion të tyre edhe 5 biblioteka online ²³³ ku janë: Questia; Elsevier; Getty; ERIC – Education Resources Information Center dhe Cambridge Journals.

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë rezultoi se ajo është e pajisur me pajisjet kompjuterike me qëllim kryesor aksesimin e shpejtë të bibliotekave online të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Cdo vit akademik Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme harton një plan për zërat që do shtohen në bibliotekë duke mbajtur në vëmendje cilat janë nevojat e studentëve në programin përkatës. Biblioteka elektronike mund të aksesohet nga studentët dhe në distancë, jo vetëm brenda ambjenteve të universitetit si facilitet shtesë për ta. Po ashtu referuar dokumentacionit ²³⁴ të vënë në dispozicion nga institucioni rezulton se nga Departamenti ka bërë një kërkesë për literaturë në gjuhën shqipe të cilat sugjerohet t'i shtohen fondit të bibliotekës së fundmi në funksion të përmbushjes së nevojave të këtij program profesional.</p> <p><i>Por duhet theksuar se kjo literaturë jo në të gjitha rastet është e 5 viteve të fundit dhe se një pjesë e saj është literaturë që përdoren si tekst bazë për ciklin e parë të studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka ofron akses shfrytëzimi të barabartë për të gjithë studentët nga ora 8:00-16:00. Në sezone të veçanta në varësi të nevojave të studentëve biblioteka ofron dhe orarin e shërbimeve ekstra. Informimi i studentëve mbi oraret e funksionimit të bibliotekës bëhet dhe me anë të njoftimit në mjediset e institucionit. Zgjerimi i orareve të aksesit jo vetëm në sezone të vecanta por gjatë gjithë kohës, kjo në varësi dhe të kërkesave të stafit dhe studentëve, mund të ishte një lehtësi për studentët dhe stafin.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

²³⁴Evidenca R4. Nr.169. Mbi pasurimin e bibliotekës me libra të rinj.

<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se menaxhimi dhe administrimi i gjithë informacionin që lidhet me studentët ndër vite kryhet nga Sekretaria mësimore (kryesekretaria e fakultetit) si dhe nga administrator i përgjithshëm. Të dhënat mbi ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim; statistika vjetore mbi numrin e studentëve të rregjistruar, largimet etj të cilat disponohen dhe elektronikisht janë të rregjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, Rezultateve Akademike dhe Diplomave.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit që administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit përfaqësohet dhe mund të aksesohen nga Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme dhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga sistemi i brendshëm i institucionit mund të aksesohen dokumentacion përkatës për stafin akademik dhe studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe vizita në institucion konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin interaktiv të stafit akademik dhe studentëve platformën Microsoft Teams. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të e-maileve zyrtare të tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit periodikisht publikohen në kohë reale aktivitetet akademike e administrative.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni dhe nga kqyrja e faqes zyrtare web të universitetit, konkludon që informacioni që lidhet me këtë program studimi, personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme që zhvillohen publikohen në faqen e internetit të Albanian University</p>



internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	(www.albanianuniversity.edu.al) në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Në lidhje me informacionin mbi aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara ato vendosen në faqen zyrtare por dhe në rrjetet zyrtare sociale të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyllet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstatoi që plani i financimit të programit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekë dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	GVJ konstatoi që plani i financimit të programit hartohet duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre dhe shpenzimet në drejtimin që ato do përdoren.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni kryen auditim të brendshëm me anë të Zyrës së Auditit të brendshëm si dhe auditim të jashtëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare. Zyra e Auditit të

hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	brendshëm është njësi administrative e ngritur dhe funksionale brenda institucionit e cila ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të zyrës së financës dhe auditit të brendshëm. U konstatua se raportet e këtyre dy llojeve të auditimeve marrin në analizë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe vizitës pranë universitetit ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara për të tre vitet e fundit. Raporti financiar i cili përgatitet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konkludohet se situata financiare dhe bankare e universitetit ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitet për të përmirësuar më tej situatën financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Naik përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Naik përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

76

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni verën se në Albanian University pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në këtë program bëhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes, të cilat bëhen dhe publike si në faqen zyrtare të institucionit ashtu dhe në rregulloren e vet programit të studimit. Ky program studimi është organizuar në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. GJV vëren se kandidatët plotësojnë formualin e Aplikimit në Portalin e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH); më tej është universiteti që shpall listën paraprake të fituesve.</p> <p>Mësohet se institucioni mbështetet në rregulloren e tij procedurën e transferimit, dokument për të rregulluar në përputhje me ligjet në vend nga hyrja në dalje. Kandidati duke ndjekur një procedurë të caktuar dhe në afatet ligjore të përcaktuara me ligj mund të kryej ndërprerjen, transferimin e studimeve në përputhje me të drejta të plota për të gjithë. Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet “Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Zyrës së Këshillimit për Karrierë”. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me institucione dhe organizata publike dhe private , dokument.</p>
<p>kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të universitetit, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se studentëve, nëpërmjet javës orientuese, dosjes që marrin në fillim të çdo viti akademik, sekretarisë mësimore dhe zyrave përkatëse “Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve”; “Zyra e Karrierës dhe Alumnit”, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për cdo semestër, plan programet e lëndëve, fillimin e mbarimin e semestrave, sezonin e provimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Këto dy zyra ofrojnë informacion dhe mbi organizimin e institucionit si dhe të drejtat e tyre, siguron lidhjet për studentët, komunitetin e gjerë universitar dhe botën e punës etj.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni vëren se universiteti vlerëson politikat e pranimit dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga ligjet dhe aktet nënligjore për arsimin e lartë. Ndryshimet e mundëshme në kriteret e pranimit reflektohen në Rregulloren e Institucionit²³⁵.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni konstaton se institucioni ka vendosur në zbatim dokumentin “Strategjia për Zhvillimin Institucional të Albanian University 2017-2022”. Institucioni duhet të krijojë mundësinë për të rritur aksesueshmërinë e këtij dokumenti për publikun e gjërë. Në fillim të çdo viti akademik, institucioni organizon takime të hapura me të interesuarit për ti informuar mbi programet e studimit që ofron ky kolegji. Këto takime të hapura janë zhvilluar edhe në shkolla të mesme por edhe duke i ftuar maturanët në ambjentet e AU-së. Gjithashtu AU përgatit udhëzime, fletëpalosje dhe postera për të bërë publike programet e studimit të ofruara prej tij. Institucioni ndjek politika që synojnë reklamimin dhe promovimin e tij në vazhdimësi. Veprimtaritë “Universiteti me dyer të hapura” janë veprimtari që i ftojnë maturanët në vizitojnë institucionin dhe të ndjekin orë leksioni të hapura si dhe “Java e Orientimit” për studentët e vitit të parë para fillimit të vitit akademik ndihmojnë studentët të marrin informacionin e nevojshëm. Përgjatë javëve të regjistrimit, AU vë në dispozicion të maturanëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, asistentë e pedagogë sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

²³⁵1.2 Rregullore e përgjithshme AU, dokumenti 11

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni nëpërmjet Sekretarisë mësimore të universitetit vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm për kriteret dhe procedurat e kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve fillon që në takimet e hapura që zhvillojnë me studentët potencial, nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Në dispozicion të studentëve të programeve të studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së regjistrimit. Gjithashtu duke përdorur platformën digjitale studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semstrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Pedagogët gjithashtu e japin këtë informacion në fillim të cdo semestri për secilën prej lëndës apo modulit që japin.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të universitetit, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në çdo fillim viti akademik ngrihet Komisioni për Njohjen e Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, e cila bazuar në aktet ligjore në fuqi, procedurat e parashikuara në rregulloren mësimore dhe në rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve mundëson procedurën e transferimit të studimeve²³⁶.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e dërguar konkludon se informimi i studentëve në lidhje me procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit mundësohet si gjatë javës së orientimit ashtu dhe në orën e parë të zhvillimit të lëndës ku stafi akademik kryen prezantimin e përmbajtjes së syllabusit, si dhe mënyrën e kontrollit të njohurive dhe mbi të gjitha detyrimet e lëndës. Po ashtu pranë sekretarisë mësimore ata kanë mundësinë të informohen direkt mbi mbi vlerësimet që ata kanë marrë në lëndë të ndryshme gjatë vitit, por edhe në përfundim të semestrave.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se në manualin e studentit është i specifikuar plani i diplomimit; i cili është gjithashtu pjesë e prezantimit që bëhet në fillim të vitit akademik.</p>

²³⁶II. 6. Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve-25.06.2020.



dhe diplomimit në programin e studimit.				
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se universiteti ka zyrën e Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve, e cila është zyrë përgjegjëse dhe vendos në dispozicion të studentëve materiale dhe broshura informuese me qëllim informimin e tyre mbi licencimin e programit, akreditimin e tij si dhe planin mësimor që do të zhvillojnë gjatë ciklit të studimit. Po ashtu Manuali i Studentit është dokument i rëndësishëm që vihet në dispozicion të studentëve nga kjo zyrë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e programit të studimit master profesional në “Psikologji Klinike” informohen në lidhje me programin e studimit, organizimin e vitit akademik dhe kuadrin rregullator përkatës që në momentin e regjistrimit pranë univërsitetit, si dhe më pas në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik i Departamentit të psikologjisë së Përgjithshme, nga sekretaria mësimore, gjatë javës së orinetimit, si dhe pedagogët që japin mësim në këtë program studimi. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve përmes një morie formash. Duke nisur me informacionin në faqen online të AU-së, përmes kontratës që nënshkruan, informacionit që merr nga zyra e Kujdesit për studentët, këshillimit nga stafi akademik në faza të ndryshme si dhe rregullores mësimore të programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se dosja e studentit që ju jepet në fillim të vitit akademik ka informacion programin e studimit informacion mbi lëndët/modulet, përmbajtjen, listën e literaturës së detyrueshme dhe këshillueshme si dhe veprimtaritë formuese. Në dispozicion të studentëve të programeve të

<p>përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>studimit aksesit tek informacioni mbi kurrikulën dhe programin e studimit mund të merret në faqen zyrtare të institucionit, ose gjatë fazës së rregjistrimit. Gjithashtu si rezultat i kushteve të pandemisë globale, zhvillimi i mësidhënies online duke përdorur platformën digjitale “Google classroom” studentët mund të marrin informacion për lëndët që do të zhvillojnë përgjatë semstrit dhe vitit akademik. Silabuset e lëndëve mësimore përmbajnë informacione të detajuara mbi ngarkesën, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GJV konkludon se institucioni ka zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t, e cila është në shërbim të studentëve dhe ish-studentëve. Zyra disponon informacion të detajuar mbi të diplomuarit në vite; përfshirë këtu punësimet e të diplomuarve ndër vite apo dhe studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme. Funkcionet e kësaj zyre përfshijnë: dhënien e referencave për studime dhe punësim, angazhimin në projektet e universitetit, publikimin të punimeve shkencore të studentëve të diplomuar në Revistën shkencore, organizimin e takimeve mes studentëve të diplomuar me studentët aktualë për shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.</p> <p>Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet “Zyrës së këshillimit për karrierë”. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me organizata publike dhe të biznesit. Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjithashtu në AU, funksionon Bordi i tregut të punës, i cili shërben si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës, ekperiencat në institucione të tjera si pjesë e realizimit të praktikës profesionale janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.</p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se mënyra se si studentëve ju vihet në dispozicion informacioni mbi infrastrukturën dhe programin e studimit me anë të faqes zyrtare të “Albanian University” si dhe rrjeteve sociale zyrtare. Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet “Zyrës së Burimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Jashtë dhe Pranimi dhe Këshillimit për karrierë”. Për këtë qëllim shërbejnë edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka lidhur me organizata publike dhe të biznesit²³⁷.</p> <p>Institucioni ka në dispozicion të orientimit profesional të studentëve zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti. Gjithashtu në AU funksionon Bordi i tregut të punës, i cili shërben si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Organizimi i panairëve të punës dhe aktiviteteve të tilla si leksione të hapura me aktorë nga tregu i punës, ekperiencat në institucione të tjera si pjesë e realizimit të praktikës profesionale janë veprimtari që synojnë të qartësojnë studentët dhe të orientojnë rreth mundësive për punësimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>GVJ konkludoi se institucioni siguron informacion të arritshëm edhe në distancë për studentët me anë të: faqes zyrtare të Albanian University (www.albanianuniversity.edu.al), komunikimi në vijimësi në nivel departamenti, njoftimi përmes platformës Teams dhe adresave të email si dhe njoftimeve në rrjetet sociale. Përmes platformës on-line, institucioni ofron mundësi për çdo lloj kërkese që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si p.sh. caktimi detyrave të kursit, të gjitha llojet e vlerësimit, pyetësorë të ndryshëm, evente, forume diskutimi online mes studentëve dhe pedagogut, dhe shumë funksione të tjera. Ky sistem ka rezultuar i dobishëm vecanërisht përgjatë këtij viti akademik si pasojë e pandemisë Covid 19, ku aksesimi ka qenë gati 100% nga studentët, sic shprehen pedagogët gjatë takimit. Sistemi u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Çdo informacion aksesohet nga cilido i interesuar në kohë reale. Gjatë</p>

²³⁷ Dokument 2.08 Raporti I fundit periodik analitik I perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimitne funksion te realizimit te programit.

	intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se cdo pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët, të cilët mund ta aksesojnë ose nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorin e teknologjisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se Albanian University disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të regjistruar në programin e studimit për çdo vit akademik, si dhe për numrin e studentëve ndër vite. Referuar (<i>RVB Mp. Psikologji Klinike dhe tabelat vulosur.pdf, tabela nr. 21</i>) dhe nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vite akademike është: Viti 2019 – 2020 25 studentë gjithsej; Viti 2020 – 2021 6 studentë gjithsej;
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon nga ana e universitetit bëhet kujdes për dokumentacionin që pasqyron çdo vit numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërhiqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit. Informacioni disponohet nga Sekretaria mësimore.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se sekretaria mësimore ka përgjegjësinë dhe disponon në regjistrin përkatës të gjitha të

<p>studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>dhënat e studentëve nga pranimi deri në diplomim. Sekretaria mësimore rregjistron informacionin (vlerësimin me notë) mbi ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi i tyre deri në diplomimin e tyre. Statistikat për ecurinë e studentëve janë të pasqyruara përgjatë të dy viteve dhe fokusohen në të dhëna mbi numrin e studentëve sipas viteve të studimit, nota mesatare e hyrjes dhe e daljes, student të transferuar sipas viteve, edhe pse për këtë program studimi profesional nuk rezulton asnjë student i transferuar dhe vetëm një student i c'rrëgjistruar.</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni i menaxhon të dhënat e studentëve të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akademike, në Regjistrimin e Diplomave. Të dhënat janë edhe në variantin elektronik. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. Detyrat e sekretarisë janë të përcaktuara në rregullore e sekretarisë mësimore. Zyra e regjistrimit të studentëve që realizohet përmes sekretarisë mësimore është struktura e posaçme që merret me ruajtje dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre në drejtim të menaxhimit të rekordeve të studentëve e realizojnë edhe përmes sistemit informatik elektronik. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e AU-së. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit si deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, Deftesë dhe listë notash e noterizuar e shkollës së mesme, kontrata e studentit. Këto të dhëna vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit. Personat e autorizuar mbështeten në sistemin e brendshëm të informacionit dhe rregjistrat për të gjeneruar statistika mbi studentët në mënyrë të saktë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, institucioni me anë të Sekretarisë mësimore në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit si dhe Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme na vuri në dispozicion evidencën përkatëse lidhur me mesatarja në hyrje dhe në dalje të studenteve të diplomuar ne programin master profesional si dhe të dhënat mbi punësimet e tyre. Rezulton se 70% studentëve të programit të studimit Master Profesional në</p>

	"Psikologji Klinike" janë të punësuar në profilin e Psikologut Klinik në institucione shtetërore dhe jo-publike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ universiteti ka parashikuar në organizimin dhe funksionimin e tij pjesëmarrjen e studentëve. Kjo vendimarrje mundësohet përmes përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur në Senatin Akademik, Këshillin Studentor, Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional si dhe Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin. Nëpërmjet Statutit të AU-së, rregullores së Fakultetit dhe rregullores së Departamentit të Psikologjisë, institucioni parashikon angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si këshillin e studentëve, i cili është grupim i studentëve dhe përzgjedh përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të AU-së. Përfshirja e studentëve në një sërë strukturash vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përcaktuar në aktet ligjore dhe rregulloren dhe statutin e vetë IAL-it.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në Statutin e institucionit (neni 47) "Të drejtat e studentëve", është e përcaktuar që studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në vendimarrje, këshillime apo vlerësim e në procesin akademik. Ata janë pjesë e disa komisioneve në të cilët japin kontributin e tyre si komisioni ad-hoc për zhvillimin e planprogrameve, komisionet e zhvillimit të strategjive dhe prioritetëve në nivelin e njësisë bazë etj. Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentet e vëna në dispozicion, GVJ konfirmoi se studentët ishin realisht të përfshirë në këshillim dhe vendimarrje. Studentët kishin përfaqësuesin e tyre si në Senatin e kolegjit, në këshillin e etikës, edhe në zyrën e</p>

	<p>NJBSC. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor. Në të gjitha strukturat ku përcaktohet me ligj përfshirja e tyre, kemi një angazhim të shprehur qartë në lidhje me rolin e studentëve. Ato janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik, punojnë së bashku me stafin në grupet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, dhe janë në brendësi të punës së tyre në këtë veprimtari. Studentët janë të përfshirë në grupime studentore të ndryshme. Në lidhje me vlerësimin e stafit akademik studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes plotësimit të pyetësorit “Për vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies” dhe përmes fokus grupeve.²³⁸.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, programi i Studimit Master Profesional në “Psikologji Klinike” realizohet me 60 ECTS, 8 prej të cilave përfitohen për projektin kërkimor të realizuar në kuadër të tezës së diplomës. Kohëzgjatja normale është 1 vit akademik (dy semestra). Ngarkesa akademike e studentëve në këtë program studimi është hartuar dhe zbatohet duke respektuar ligjet dhe aktet nënligjore të institucionit dhe në harmoni dhe me udhëzimet dhe vendimet e MASR. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesa e shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra (afërsisht 30 ECTS për semestër). Ka rregullore dhe procedura që lehtësojnë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme të realizuara më parë ose më pas nga studenti. Grupi i Vlerësimit të jashtëm konstatoi se programet e studimit janë hartuar duke mbajtur parasysh ngarkesën akademike të studentëve Statuti AU-së dhe rregulloret përkatëse parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon neni 25 i Statutit të “Albanian University” garanton përfaqësimin e studentëve në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisioni për Vlerësimin Institucional dhe Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.</p> <p>Përfshirja reale e studentëve në organe këshilluese dhe vendimarrëse, bën të mundur që studentët të japin mendimin e tyre mbi hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit. Si një mënyrë e drejtëpërdrejtë në këtë drejtim shërben edhe pyetësi që plotësohet nga studentët në fund të çdo semestri. GVJ konstatoi se pyetjet në pyetësor lidheshin më shumë me performancën e pedagogut se sa me programin e studimit dhe në fakt nuk përbën një burim informacioni në këtë drejtim.</p>

²³⁸ Dokument 2.11 Pyetësi i studenteve .

<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se personeli akademik e ka në vëmendje barazinë dhe meritkracinë e studentit në vlerësim dhe në mënyrë hierarkike shqyrtohet çdo ankimim. Studentët kanë të drejtën e ankimimit sipas procedurës brenda tre ditëve nga shpallja e rezultateve të provimit.</p> <p>Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Shoqërore, rregullorja e Departamentit të Psikologjisë dhe rregullorja e programit të studimit master profesional mundësojnë barazinë dhe objektivitetin në vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve. Atyre u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. vlerësimin e procesit të kontrollit të dijeve, duke u dhënë të drejtën e ankimimit studentëve si dhe nëpërmjet përcaktimit të procedurës që ndiqen nga institucioni në këtë rast. Studentëve u mundësohet një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, i cili shprehet në rregulloret e brendshme të programit të studimit. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashetrojnë kërkesat e tyre duke drejtuar një kërkesë në njësinë bazë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni ka zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t, e cila është në shërbim të informimit të studentëve. Ajo që vihet re është që ka një njohje jo të plotë dhe të detajuar të funksionit të kësaj zyre. Në këtë kontekst sugjerohet</p>

	që të punohet më shumë në drejtim të njohjes dhe promovimit të kësaj zyre.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion vihet re se veprimtaria e zyrës së Këshillimit të Karrierës orjentohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e rregjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre ofron, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj. Po ashtu ky institucion me qëllim mbështetjen profesionalisht të studentëve dhe ti ndihmojë ata në planifikimin e karrierës ofron dhe udhëheqje dhe kujdestari (tutorat) për studentët dhe përgjegjëse për këtë është Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Detyrat dhe funksionimi i Zyrës së Këshillimit të Karrierës ²³⁹ janë të përcaktuara në Rregulloren e Këshillimit të Karrierës, të miratuar me Vendimin nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik. Po ashtu ky institucion ka hartuar dhe miratuar dhe Udhëzuesin për zhvillimin e karrierës ²⁴⁰ e cila përcakton instrumentat kryesorë për zhvillimin e karrierës.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	<i>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar²⁴¹, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ rekomandon se Zyra duhet të ndjek studentët pas diplomimit, të mbledhë dhe të përpunojë të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.</i> Këtë analizë e kishte bërë për disa programe të studimit në të cilat ka studentë të diplomuar. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ-së në takimin me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi, si dhe me studentët e këtij program studimi u bë me dije se shumica e studentëve tashmë ishin

²³⁹Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit. Dokumenti nr 49.

²⁴⁰V.3.Udhëzuesi për zhvillimin e karrierës.

²⁴¹7. Statistika të Punësimit Alumni, dokumenti 10

	të punësuar. <i>Rekomandohet kryerja periodikisht e të dhënave të tilla.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues, GVJ konstaton se Albanian University ka hartuar politika në nivel institucional si dhe ka ngritur strukturat përkatëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të duhur. Këto politika janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë si dhe me Manualin për “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga shqyrtimi i informacionit të paraqitur në RVB dhe dokumentacionit shoqërues rezulton se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në këtë institucion funksionon që nga viti 2009 -2010. Vendimi i Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010 përcakton ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Po ashtu ky institucion ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional në përputhje me ligjin 80/15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016. Një student është pjesë e tij. Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë është ngritur me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016.

<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se universiteti i kushton një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj e grada shkencore. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë²⁴² me studentët, stafin akademik, fokus grupet²⁴³ për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.²⁴⁴</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në universitet, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional, në pikën 7 paraqitet saktësisht politikat e përmirësimit të cilësisë për programet e studimit. Departamenti i Psikologjisë së përgjithshme plotëson raportin e vetëvlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni ka ngritur disa struktura ku më kryesoret do përmendnim: Grupet e Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti.</p>

²⁴²III.2. Pyetësori

²⁴³III.2. Shkresë fokus grupe.

²⁴⁴III.2. Pyetësori

	Këto grupe kanë si funksion monitorimin dhe vlerësimin e procesit të mësimdhënies në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në bashkëpunim me Departamentin përgjegjës.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe atë të marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit angazhon titullarët, lektorët e lëndëve dhe asistent-lektorët në azhurnimin e syllabuseve në përputhje me të rejat e fushës së paku në 5 vitet e fundit. Monitorimi nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit të ciklit të dytë fokusohet në dy aspekte, monitorimin e mënyrës së ndërtimit të silabusit të lëndës sipas standarteve të institucionit si dhe përmes vlerësimit të procedurave të ndjekura në drejtim të mbarvajtjes së provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni përdor metodologji vlerësimi si dhe instrumente matëse vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit Psikologji Klinike të tilla si: metoda të tërthorta (Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit); Fokus grupe (në fund të vitit), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës; Raporte vetëvlerësimi të pedagogëve; Raport vetëvlerësimi për programin e studimit, Raportet të vetëvlerësimit (2 herë në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik) dhe metoda të drejtëpërdrejta (vlerësimi me notë dhe pikë, teste paraprake dhe përfundimtare si dhe vëzhgime gjatë kryerjes së praktikave dhe ushtrimeve)
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve. Procedura që ndiqet është e tillë që pas përfundimit dhe mbledhjes së të dhënave informacioni / raporti i dërgohet Rektoratit dhe çdo njësie bazë me qëllim marrjen e masave për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, departamentit i cili i diskuton dhe komunikon personelit akademik. Këto diskutohen dhe në mbledhje të Senatit Akademik.
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se formati i raporteve të vlerësimit përfshin të dhëna përshtuese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe

	nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se raportin e vetëvlerësimit të programit të studimit kryhet në përfundim të çdo viti akademik dhe ky proces përfshin të gjithë aktorët duke filluar që nga Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë. Përsa i përket strukturës që merret me vlerësimin e brendshëm të cilësisë, ai është i lidhur me KSBC. Kjo strukturë monitoron standartet e cilësisë për të gjitha programet e studimit në rang universiteti. Grupi i vlerësimit të brendshëm të cilësisë është ngritur nga departamenti me qëllim hartimin e një raporti vlerësimi të brendshëm për këtë program studimi.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetësi i studentëve, fokus grupet dhe takimet që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që të masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes	GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se ndër metodat të drejtpërdrejta të përdorura nga institucioni përfshijnë vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve.

së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi ku përfshihen pyetësorët dhe fokus grupet e realizuara me studentët të cilat zhvillohen në baza periodike dy herë në vit pyetësorë dhe një herë në vit fokus grupe. Nga informacioni i paraqitur në RVB dëshmon evidenca që Albanian University ka realizuar në vitin akademik 2018-2019 pyetësorë me personelin akademik me qëllim marrjen e përshtypjeve të tyre në lidhje me atë çfarë i ofron institucioni dhe nivelin e kënaqësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni garanton dhe bashkëpunon me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të paramentrave të cilësisë. Për këtë ekzistojnë dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, konstaton se detyrat dhe përgjegjësitë konkrete të palëve të përfshira në çështjet e cilësisë janë të parashikuara në rregulloren e NJSBC.</p> <p>KSBS përmes aktiviteteve që ndërmerr synon të garantojë sigurimin e cilësisë. Për arritjen e këtij qëllimi janë angazhuar në realizimin e projekteve koordinatori i projektit, grupi i punës nga institucioni i përbërë nga 6 anëtarë, të cilët janë të profileve dhe mbulojnë punën në struktura të ndryshme si zyra e kurrikulës, komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë, zv. Rektorja për kërkimin shkencor dhe angazhimin e anëtarëve të departamenteve sipas rastit dhe aktiviteteve.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni kujdeset që pjesë e procedurave të vlerësimit të cilësisë të jenë të gjithë aktorët kryesore me ndikim që janë: njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ si dhe studentët.</p> <p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në përbërjen e grupit të vlerësimit të brendshëm janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik dhe studentë. Departamenti është përfshirë në procesin e sigurimit të cilësisë përmes mbështetjes me informacione dhe akses në të gjitha dokumentat që disponon, grupit të vlerësimit të brendshëm. Personeli ndihmësakademik e administrativ ka mbështetur punën e grupit të vlerësimit të brendshëm përmes informacionit dhe statistikave që lehtësojnë procesin.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi që dokumentat e tillë si Rregullorja e Përgjithshme dhe Kodi i Etikës i institucionit parashikon respektimin e të drejtave themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare.</p> <p>Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve nga bachelor dhe masterat në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe</p>	<p>Nga informacioni i paraqitur në RVB dhe atë i marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni i kushton vëmendje të veçantë sugjerimeve dhe rekomandimeve të lëna nga ekspertët e jashtëm.²⁴⁵ Personeli akademik i cili është</p>

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtrojnë detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e 3 studentëve nga bachelor dhe masterat në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni është transparent dhe publik për studentët dhe të interesuarit me anë të faqen web: https://albanianuniversity.edu.al . Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente. Politikat e institucionit në drejtim të mbështetjes dhe krijimit të lehtësirave në realizimin e një sërë veprimtarish të mbledhjes së informacionit në funksioni të realizimin të një procesi korrekt të vlerësimit të brendshëm. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë trasparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU-së. Në funksion të trasparencës do të ishin të nevojshme diskutimet me stafin dhe studentët, fokusgrupet e ndryshme, etj. Këto veprimtari do të ndihmonin trasparencën në ndarjen e informacionit me palët e interesuara dhe të përfshira, dhe gjithashtu do të lejonin marrjen e një feedback-u mbi mundësinë e përmirësimit të punës së grupit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i interesuar të ruajë dhe respektojë të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike –profesionale. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë trasparente dhe bëhen publike duke u hedhur në faqen e AU-së.

<p>legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Raportet janë pasqyruar të plota pa ndërhyrje në shmangien e dajles së të dhënave për personat që janë pjesë e të dhënave që kanë kontribuar në drejtim të mësimdhënies në këtë program studimi ndër vite, megjithatë të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt që mbajnë, por këto evidenca nuk na japin mundësi të gjykojmë mbi çënimin e lirisë për të dhënat personale.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, konstatohet se insitucioni sigurohet që raportet dhe rezultatet e vetëvlerësimit të programit përfshijën edhe të dhëna mbi masat e marra nga planveprimi. Institucioni në këto dokumenta kryen dhe adresimin e masave që duhen analizuar dhe reflektuar. Grupi i vlerësimit të brendshëm ka paraqitur rezultatet e vlerësimit të tij për këtë program studimi. Në përmbyllje të raportit të tij ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Ka një tendencë për t'u fokusuar në evidentimit e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, dhe përse i përket sugjerimeve për masat që mund të ndërmerren në drejtim të pikave të dobëta mbeten të paqarta format sesi mund të ndihmohet njësia bazë dhe kryesore, por edhe institucioni për të përmirësuar ato në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, krijon grupin përmes delegimit të përgjegjësive, strukturave përgjegjëse dhe mbështet punën e grupit përgjatë kryerjes së detyrës. Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit mbetet i paqartë sesi përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ashtu sic mbetet e paqartë nëse ka pasur ndonjë reagim nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara nga grupi i vlerësimit të brendshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se institucioni me anë të veprimtarive periodike si java e orientimit, sesione trajnimi të shumta që realizon në fillim të çdo viti akademik informimin dhe ndërgjegjësimin e studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Angazhimin e stafit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë e kërkon baza ligjore në funksion të cilësisë në mësimdhënie si edhe nga rregulloret e AU-së dhe statuti, një sër strukturash të ngritura me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë përfshijnë në përbërje të tyre (KSBC, GVB). Por mbeten të paqarta format sesi bashkëpunohet në</p>

	drejtimtë përmirësimit të cilësisë në programin e studimit në vijimësi të daljes së rezultateve për raportin e vlerësimit të brendshëm. Nëse ndahen dhe bëhen objekt i diskutimeve publike me palët e interesuara siç mund të jenë departamenti, stafi akademik dhe studentët e programit. Mbetet e paqartë, nëse raporti është prezantuar diku, apo është thjesht një raport që duhet të realizohet t'ju vënë në dispozicion ASCAL- it dhe grupit të vlerësimit të jashtëm të këtij programi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë "Master Professional" në "Psikologji Klinike"

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Qendrat për realizimin e praktikës profesionale janë në përputhje me profilin e masterit profesional në "Psikologji Klinike" duke krijuar mundësi reale në drejtim të zhvillimit të kompetencave profesionale për studentët e këtij program studimi;
2. Zyra e këshillimit psikologjik dhe ajo e këshillimit të karrierës të përshtatshme për mbështetjen e veprimtarive në funksion të praktikës klinike dhe praktikës profesionale;
3. Praktika të mira, të ndërmarra nga komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes punës me trajnimet e stafit dhe fokus-grupet me studentët;
4. Përfshirja e studentit në vlerësimet periodike të formave të mësimdhënies dhe të stafit akademik;
5. Abonimi në bibliotekën online Questia, Eric plus dhe COBISS Net;
6. Klima pozitive në komunikimin midis stafik akademik dhe studentëve të këtij programi studimi;
7. Infrastruktura fizike në funksion të këtij programi studimi u jep mundësi studentëve të këtij programi për kushte të përshtatshme në të cilin realizohet procesi i mësimdhënies;

b. Pika të dobëta:

1. Profilizimi i stafit jasht fushës profesionale të psikologjisë klinike si dhe mbulimi i ngarkesës në auditor nga një pedagog në më shumë se dy lëndë rrezikon cënimin e cilësisë në mësimdhënie, ku një profesionist mbulon njëherësh një sër lëndësh;
2. Dublimi i literaturës bazë për lëndë të ndryshme mësimore vlerësohet se ndikon negativisht në mospërbushjen e synimeve të lëndës;
3. Literatura e vjetëruar, të cilat nuk janë përditësuar me literaturë të 5 viteve të fundit evidentohet tek pothuajse pjesa dërrmuese e syllabuseve të lëndëve/moduleve;
4. Mungesa e një sistemi që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe të luftojë plagjiaturën;
5. Mungesa e bashkëpunimit me bordin e punës, me qëllim mbështetjen e studentëve drejt punësimit brenda fushës së studimit;

Rekomandime

1. Rekomandohet vendosja e një sistemi që i lejon institucionit të monitorojë pandershmërinë dhe lufton plagjiaturën, gjë që do e lehtësonte mjaft këtë proces;
2. Rekomandohet stafi akademik të angazhohet në një proces përmirësimi të literaturës së përdorur për nevojat e lëndës mësimore dhe në përputhje me emërtimin e saj;
3. Rekomandohet një punë më e mirë nga njësia bazë në drejtim të monitorimit me kujdes të syllabuseve të lëndëve që miraton, pasi ky aspekt duke iu referuar syllabuseve të lëndëve paraqeset mangësi të dukshme të cilat duhet të adresohen shpejt dhe drejt në mënyrë që të mos cënojnë cilësinë e programit të studimit dhe të shërbimit që meritojnë të marrin studentët e masterit profesional në “Psikologji Klinike”;
4. Rekomandohet njësia bazë të tregojë kujdes dhe t’iu japë rëndësinë e duhur gjatë fazës së përzgjedhjes së stafit akademik të këtij masteri, respektimit të kriterëve si eksperiencia në mësimdhënie brenda këtij profili profesional dhe kontributit në kërkimin shkencorë përmes krijimtarisë personale në fushën e psikologjisë klinike, publikimit të artikujve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjes në konferenca e simpoziume shkencore;
5. Mbështetur në raportin e vlersimit të brendshëm dhe në syllabuset e lëndëve mësimore, kërkohet një angazhim më i madh i strukturave të institucionit në drejtim të pasurimit të fondit të bibliotekës;
6. Rekomandohet të tregohet kujdes në ruajtjen e një balance përsa i përket numrit të lëndëve dhe llojit të profilit që mbulon secili pedagog i angazhuar në këtë program studimi;
7. Shfrytëzim më i mirë i të dhënave që departamenti nxjerr nga analiza e punës së pedagogut të lëndës në fund të çdo semestri;

8. Rritja e bashkëpunimit me bordin e punës, me qëllim mbështetjen e studentëve drejt punësimit brenda fushës së studimit;

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle "Professional Master" in "Clinical Psychology".

a. Strengths and affirmations:

1. Centers for the realization of professional practice are in accordance with the profile of the professional master in "Clinical Psychology" creating real opportunities in terms of developing professional competencies for students of this study program;
2. The office of psychological counseling and that of career counseling suitable for supporting activities in function of clinical practice and professional practice;
3. Good practices, undertaken by the internal quality assurance commission through working with staff trainings and focus groups with students;
4. Involvement of the student in the periodic evaluations of the forms of teaching and of the academic staff;
5. Subscribe to the online library Questia, Eric plus and COBISS Net;
6. Positive climate in the communication between the academic staff and the students of this study program;
7. The physical infrastructure in function of this study program gives the students the opportunity of this program for suitable conditions in which the learning process is realized;

b. Weaknesses:

1. Profiling of staff outside the professional field of clinical psychology as well as coverage of the workload in the auditorium by a lecturer in more than two subjects risks compromising the quality of teaching, where a professional simultaneously covers a variety of subjects;
2. Duplication of the basic literature for different subjects is considered to have a negative impact on the non-fulfillment of the subject objectives;
3. Outdated literature, which have not been updated with literature of the last 5 years is evidenced in almost the majority of the syllabus of courses / modules;
4. Lack of a system that allows the institution to monitor dishonesty and fight plagiarism;
5. Lack of cooperation with the labor board, in order to support students towards employment within the field of study;

Recommendations

1. It is suggested to establish a system that allows the institution to monitor dishonesty and fight plagiarism, which would greatly facilitate this process;
2. It is suggested that the academic staff engage in a process of improving the literature used for the needs of the subject matter and in accordance with its name;



3. A better work is suggested by the basic unit in terms of careful monitoring of the syllabus of the subjects it approves, as this aspect referring to the syllabus of the subjects presents obvious shortcomings which should be addressed quickly and correctly so as not to harm the quality of the study program and the service that the students of the professional master in "Clinical Psychology" deserve to receive;
4. It is suggested that the basic unit show care and give it due importance during the selection phase of the academic staff of this master, respecting the criteria such as teaching experience within this professional profile and contribution to scientific research through personal creativity in the field of clinical psychology, publication of articles in indexed journals and participation in scientific conferences and symposiums;
5. Based on the internal evaluation report and the syllabus of the teaching subjects, a greater commitment of the structures of the institution is required in terms of enriching the library fund;
6. It is suggested to be careful in maintaining a balance regarding the number of courses and the type of profile covered by each lecturer engaged in this study program;
7. Better use of data that the department derives from the analysis of the work of the course lecturer at the end of each semester;
8. Increase cooperation with the labor board, in order to support students towards employment within the field of study;



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen përbush	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE					X
VLERËSIMI TËRËSOR					X